



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02/Nr. _____ /2012

Data:	02.07.2012
NGA :	Kryetarit të Komunës Rufki Suma
PËR :	KPF-në dhe Kuvendin e Komunës
LËNDA:	Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës

Të nderuar këshilltar;

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim Raportin gjashtë mujor të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Drejtorive komunale

Me respekt .

RAPORTI
I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2012

Grupi punues:

- Kryetari i komunës - Rufki Suma
- Nënkryetari i komunës - Muzafer Dernjani
- Drejtori i drejtorisë për Administratë - Fari Kalisi
- Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Shabi Rexhallari
- Drejtori i drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë – Rufat Shkreta
- Drejtori i drejtorisë për BPZHR – Besnik Reçi
- Drejtori i drejtorisë për Zhvillim Ekonomik – Xhevdet Shkreta
- Drejtori i drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit– Miqail Vila
- Drejtori i drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Safet Bushi
- Drejtori i drejtorisë për Arsim Kulturë Rini e Sport – Nesim Dernjani

Korrik 2012

TË NDERUAR KËSHILLTARË TË KUVENDIT KOMUNAL

Viti 2012 ishte vit i vazhimit te sukseseve të komunës, vit i realizimit te projekteve te mbetura nga viti i kaluar dhe i realizimit te projekteve te reja.

Per dallim nga viti 2011 këtë vit buxheti i komunës është alokuar me herët dhe me kohë e cila mundësoi që edhe projektet dhe aktivitetet e komunës të fillojnë me kohë.

Ndër prioritet e administratës së komunës edhe këtë vit ishte aplikimi i ligjshmërisë, në kuadër të saj dhe

- Hartimi i rregulloreve për të përligjësuar të gjitha aktivitetet e saja
- Hartimi dhe përtirja e infrastrukturës ligjore në kuadër të komunës
- Bashkëpunimi i komunës me qeverinë dhe faktorin ndërkombëtar në Kosovë

-Vazhdimi i kontinuitet të projekteve të filluara në vitin 2011 dhe implementimi i projekteve prioritare për vitin 2012

-Ngritja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore në kuadër të komunës

Bashkëpunimi i administratës komunale, gjatë kësaj periudhe është shumë i begatshëm duke filluar nga qeveria ku me sukses kemi vazhduar projekte të cilat ishin filluar më herët, siç është asfaltimi i rrugës Hani i Elezit- Gorancë

Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë konkretizuar edhe disa marrëveshje të bashkëpunimit për të realizuar edhe disa projekte të rëndësishme si;

1. Marrëveshje mes Komunës dhe Bashkësisë Islame të Hanit të Elezit për heqjen e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Hanit të Elezit
2. Memorandum Mirëkuptimi me MAPL për instalimin e teleprezencës në Kuvendin e Komunës
3. Marrëveshja e mirëkuptimit me MPMS për financimin e projekti – Rregullimi i rrugës Ura e Fejzës-Rrafshe-Meliq, në vlerë prej 130.000.00 euro
4. Marrëveshje mirëkuptimi mes MAPL- për financimin e projektit – Asfaltimi i rruges Lagja e Re-Pustenik në vlerë prej 120.000.00, Ministrisë së Infrastrukturës ku për vitin 2012 do të jepë 60.000 ndërsa në vitit 2013 do të jepë 250.000.
5. Marrëveshje mirëkuptimi me LOGOS Intercooperation –për financimin e dy projekteve
 - Rregullimi i trotuarit nga Lagja e Krasniqëve deri te shkolla fillore “Kështjella e Diturisë në fshatin Paldenicë
 - Furnizimi me kontinjerë për mbeturina për tërë komunën
4. Marrëveshje Mirëkuptimi me USAID-in për furnizimin e shkollave me llaptop dhe projektor (nga 50 llaptop dhe projektor)
5. Marrëveshje me UNDP-në për financimin e projektit ndërkomunal “Shenjzimi i Vijës Kufitare me Kaçanikun

6. Memorandum për Bashkëpunim ndërkomunal me Kaçanikun për realizimin e projektit “Shenjzimi i Vijës Kufitare
7. Marrëveshje Mirëkuptimi me degën e OVL të UÇK-së, për Mirëmbajtjen e Varrezave të Dëshmorëve.
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me komunën Haraqinë të Maqedonisë
9. Memorandum Mirëkuptimi me USAID-DEMI për trajnimin e stafit arsimor për projektin “Klasa e shekullit 21”
10. Marrëveshje Mirëkuptimi me KEK-un për bashkëfinancimin e rrjetit elektrik në rrugën “Hysen Suma.
11. Marrëveshje Partneriteti me Komisionin Evropian në projektin “Kulturë për të gjithë” për furnizimin me libra të bibliotekës komunale.
12. Memorandum Mirëkuptimi për Zhvillimin e Turizmit Regjional-Lindje mes komisionit Evropian-komunës Ferizaj dhe Hani i Elezit.
13. Memorandum Mirëkuptimi me organizatat FIQ dhe Saferworld për instalimin e kamerave në institucionet shkollore.
14. Memorandum Mirëkuptimi me UN-HABITAT-in për vazhdimin e projektit –Faza e tretë

Në kuadër të bashkëpunimit me organizata të ndryshme janë zhvilluar edhe vizita studimore jashtë vendit si në Maqedoni, Shqipëri, Mali i Zi.....

Të nderuar këshilltar

Në janar të këtij viti është dorëzuar zyrtarisht në Prokurorinë Speciale të Gjykatës Supreme, Padia kundër Sërbisë për Krimet e kryera në territorin e komunës nga viti 1989 deri më 11 qershor të vitit 1999.

Kam dërguar shkresë të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për mos përdorimin e emërimit Gjeneral Jankoviq për Hanin e Elezit, reagim i cili kishte sukses sepse menjëherë u bë ndërrimi i vulave në pikën kufitare ku tani e tutje shkruhet vetëm Hani i Elezit, gjithashtu Ministria e Financave nga faturat e tatimit ne pronë ka hequr përdorimin Gjeneral Jankoviq, të njëjtën gjë e kanë bërë edhe shumë institucione vendore dhe ndërkombëtare, por sfida për ne do të jetë edhe më tutje ky emërtim derisa kjo të ndërrohet me ligj, por nga kjo çështje veç është futur zyrtarisht në ndryshimin e ligjit për përdorimin e emërimit të vendbanimeve, ku pritet të ndryshohet në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Kemi arritur Marrëveshje me Sharrcemën për formimin e një Bordi të Përbashkët Komunë-Komunitet-Sharrcem, në bazë të së cilës Sharrcemi në çdo 3 muaj do të ndajë nga 15.000 Euro ndihmë komunitetit. Ky bord ka gjithsejtë 9 anëtarë dhe atë 2 anëtarë nga Sharrcemi, 4 nga komuniteti dhe 3 nga komuna.

Është vendosur stacioni për monitorimin e Cilësisë së Ajrit pranë shkollës fillore “Ilaz Thaqi” nga ana e Institutit Meteorologjik e cila funksionon pranë MMPH.

Në muajin maj KFOR-i gjerman fillimisht trajnoi në kampin e tyre në Prizren zjarrëfiksat e Hanit të Elezit e më pastaj solli si donacion një kamion për fikjen e zjarrit.

Janë mbajtur dy debate me qytetarë përkrahur edhe nga organizata Logos, një në shkurt të këtij viti në lidhje me raportin buxhetor të vitit 2011 dhe tjetri në qershor në

lidhje me planifikimet buxhetore 2013-2015 dhe raporti i kryetarit për gjashtëmujorin e parë,

Është mbajtur një debat televiziv me emisionin “Jeta në Komuna” për premtimet e kryetarit gjat elektoratit,

Gjithashtu vlen të përmenden manifestimet e organizuara me 17 shkurt për përvjetorin e Pavarësisë, 26 shkurtin Krismën e pushkës së Parë, 11 Qershorin ditën e Çlirimit.

Gjithashtu vlen të përmendet se ekzekutivi i komunës mbanë çdo të hëne takimet me bordin e drejtorëve, ndërsa çdo të premte të fundit të muajit mbahen takimet e rregullta të KKSB-së.

Në kuadër të zyrës së Kryetarit veprojnë edhe këto zyre:

- **Zyra e personelit**
- **Zyra e prokurimit**
- **Zyra ligjore**

ZYRA E PERSONELIT

Në zyrën e personelit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012 ka pasu një varg aktivitete, duke filluar nga kontrolli dhe evidentimi i prezencës në punë i gjithë punëtorëve, mirëmbajtjen e dosjeve, menaxhimin e pushimeve vjetore, kërkesat dhe shkresat përcjellëse Ministrisë së Administratës Publike, bashkëpunimi me Departamentin e Shërbimit Civil, njoftimin e punëtorëve rreth pushimeve dhe festave zyrtare, ndjekjen e trajnimeve dhe zbatimin e ligjit të Shërbyesve aty ku nuk kan munguar aktet tjera nënligjore.

Në mënyrë të rregullt dhe sistematike, nga Zyra e Personelit me anë të aparatit digjital, është bërë evidentimi i gjithë punëtorëve. ku gjatë kësaj periudhe kemi pasur një rast vonese pa arsye.

Gjithashtu përpos evidentimit të rregullt, që bëhet çdo ditë pune, Zyra e Personelit poashtu ka bërë edhe vizita (inspektime) mbrenda orarit, rreth prezencës në punë, ku përgjithësisht është rrespektuar orari i punës.

Në qershor të këtij viti është bërë përmbyllja e gjithë pushimit vjetorë për vitin 2011. Pas miratimit të kërkesave nga menaxherët drejtues, janë përgaditur dhe vendosur në dosje personale nga Udhëheqësja e Personelit dosjet e pushimit vjetorë për vitin 2011 dhe janë përgaditur 2 dosje të pushimit vjetor për vitin 2012 kemi pasur raste të pushimit mjeksorë, ku pas lëshimit nga ana e mjekut të raportit mjeksorë është bërë evidentimi i tyre nëpër dosje personale.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti janë bërë 2(dy) kërkesa për Ministrinë e Administratës Publike për autorizimin e shpalljes së konkurseve dhe kanë të bëjnë me :
1.pozitën Zyrtar për Kulturë,Rini dhe Sport dhe
2.për pozitën Zyrtar i Prokurimit.

Duhet theksuar se Zyra e Personelit ka filluar procedurën e Rekrutimit për pozitën e zyrtarit për Kulturë,Rini dhe Sport, është bërë shpallja e konkursit, është përmbyllur

afati i konkurimit, është caktuar Komisioni Përzgjedhës dhe rekrutimi i zyrtarit është në fazat tjera të cilat rregullohen me rregulloren nr02/2010 mbi procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil, ndërsa për pozitën e zyrtarit të prokurimit MAP ende nuk ka kthyer përgjigje.

Nga zyra e Personelit gjatë gjashtë mujorit të pare janë bërë gjithsej 4 njoftime rreth ditëve të pushimit për festat zyrtare për gjithë nëpunësit civil .

Gjithashtu sipas evidencës që posedon zyra e Personelit dhe me kërkesë të vetë palës është lëshuar 1 vërtetim mbi mardhënien e punës.

Kam marrë pjesë rregullisht në mbledhje te bordit të Drejtorëve, dhe pjesërisht edhe në mbledhje të Kuvendit.

Me qëllim të zbatimit dhe implementimit të plotë të Ligjit të Shërbyesve Civil, në këtë gjashtëmuor të pare të viti janë mbajtur disa trajnime dhe atë 1 trajnim 2 ditor në IKAP rreth rregullores për klasifikimin e vendeve të punës gjithashtu është mbajtur 1 takim pune në MAP për procesin e zbatimit të rregullores për organizimin e mbrendshëm dhe rregullores për klasifikimin e vendeve të punës për Nëpunësit Civil. Gjithashtu kam qenë pjesë e grupit të Akademisë për Qeverisje Lokale nga komuna e Hanit të Elezit, kjo Akademi është organizuar nga Instituti i Kosovës për Qeverisje Lokale, kemi pasur gjithsej 5 module ku dy prej tyre janë zhvilluar jashtë vendit, një në Shqipëri nga data 21.03.2012 deri 24.03.2012 dhe një në Ulqin, Mal të Zi, nga data 12.06.2012 deri 14.06.2012, gjithashtu pjesë e kësaj Akademie ka qenë edhe vizita stuimore në 3 shtete të Rajonit dhe atë :Maqedoni, Shqipëri dhe Mal të Zi nga data 08.05.2012 deri 12.05.2012 ku kemi pasur vizita në nivelin qendror dhe atë lokal.

Në maj të këtij viti nga Udhëheqësi më i lartë administrative (Kryetari) është marrë vendimi për formimin e grupit punues për klasifikimin e vendeve të punës ku pjesë e këtij grupi është edhe Udhëheqësja e Personelit, grupi ka mbajtur një takim ku është informuar më hollësisht me punën që duhet ta bëjë gjatë këtij viti në mënyrë që të bëhet një klasifikim i drejtë dhe profesional

ZYRA E PROKURIMIT

Muaji Janar 2012

Zyra e prokurimit te K.Hanit te Elezit nuk ka zhvilluar asnje procedure per arsye se buxheti ska qene I alokuar dhe kemi qene ne pushim vjetor.

Muaji Shkurt 2012

Gjatë muajit shkurt kemi zhvilluar procedura të ndryshme sipas kompetencave që kemi si zyre e prokurimit:

Kemi zhvilluar procedura me urdhërblerja të vjetër dhe procedura tjera sipas ligjit në fuqi.

Urdhërblerjet me formë të vjetër janë për mbushjet Vala sipas kërkesave të drejtorive, shuma e paguar e mbushjeve Vala (zyra e kryetarit, zyra e kuvendit, drejtoria për administratë, drejtoria për buxhet dhe financa, drejtoria për arsim, drejtoria për shërbime publike, drejtoria për urbanizëm, drejtoria për shëndetësi), shuma e të gjitha urdhërblerjeve sipas drejtorive shprehur në vlerë monetare është **740.00 €**. (Vala 900). Me urdhërblerja të vjetër janë kryer edhe dreka zyrtare borxh nga viti 2011 (për muajt shtator, tetor, nëntor dhe disa fatura të muajit dhjetor). Vlera e paguar është **1,704.10 €**.

Pagesa për pije të ndryshme për Bifen për 2 muaj janar dhe shkurt me shumë **1,644.30 €**.

Pagesa për transportin e personave me hemodializë për muajin dhjetor 2011 me shumë **434.72€**.

Pagesa për punëtorët sipas kontratave në vepër të Agjensionit Pyjor (Roje Pyelli) sipas projektit të UNDP-së. pagesa e dy punëtorëve $2 \times 250.00 \text{ €} = 500.00 \text{ €}$.

Pagesa për motrën medicinale sipas kontratës në vepër me shumë **290.00 €**.

Pagesa e naftës (borxh) për muajin tetor **2011** për administratë me vlerë 1877.52 € dhe shëndetësi 670.00 € = **2547.52 €**. (shpk. "Alba-Oil" H.Elezit)

Pagesa e gazetës zyrtare me shumë **36.00 €**.

Pagesa për mirëmbajtjen e veturave sipas kontrates se mirembajtjes: Vlera e mbetur borxh per vitin 2011 me shume **574.30 €**.

Mirëmbajtja dhe servisimi I veturave për muajin janar 2012 $(73.00+390.00) = 463.00 \text{ €}$.

Pagesa e mbetur borxh **dhjetor** për Derivate për vetura sipas drejtorive : fatura **942.64 €** (Shërbimet Publike), **1362.79 €** (Administrata), **955.80 €** (Shëndetësia) = **3261.23 €**.

Pagesa për sigurimin dhe rexhistrimin e veturës Hyundai Santafe e mbetur borxh nga viti 2011 në shumë prej **297.80 €**.

Pagesa e drekës së ceromonisë së varrimit për familjen skamnore Q.B. **161.00 €**.

Procedurat që janë zhvilluar për vitin 2012 janë:

1. Mirembajtja dimerore e rrugeve te Hanit te Elezit,
2. Furnizim me laptopa, videoprojektor dhe Tv plazma për zyren e kuvendit,

3. Transporti I nxenesve per shkollen fillore Ilaz Thaqi,
4. Furnizim me kalendarë notesa etj,

Nga këto procedura të shënuara më lartë për disa janë nënshkruar kontratat (1;2;3), kurse për tjerat jemi në zhvillim procedure për nënshkrim të kontratës.

Muaji Mars 2012

Gjatë muajit mars kemi zhvilluar procedura të ndryshme sipas kompetencave që kemi si zyre e prokurimit:

Kemi zhvilluar procedura me urdhërblerja të vjetër dhe procedura tjera sipas ligjit në fuqi.

Gjate ketij muaji kemi kryer keto obligime :

Borxh nga Organizata LOGOS per vitin 2011 per Kulmin e shkolles dhe dysHEMEVE Shkollen Ilaz Thaqi ne shume prej **7,999.57 €** (NTP. “3 D Project” Prishtine).

Borxh nga Organizata LOGOS –per vitin 2011 per Nxemjen qendrore per shkollen Keshjtjella e Diturise ne shume prej **7,999.99 €** (NTP. “KRAS” H.Elezit)

Borxh nga Organizata LOGOS per vitin 2011 per Elementet e buta te shkolla Keshjtjella e Diturise(Furnizim me material sportiv dhe kulturor per sh.f. ”Keshjtjella e Diturisë”-Paldenicë – 1,987.00 € (NTP.”PROMIX” Ferizaj).

Dreke per kuzhinen popullore Expres me shume 161.00 €

Pagesa per pije te ndryshme per Administraten komunale per Byfen SAFETI ne shume 878.75 €

Vlera e fatures se sigurimit te vetures Hyundai SANTAFE e mbetur borxh nga viti 2011 ne shume prej 297.80 € .

Pagesa e kontratave ne veper per projektin per barazi gjinore LOGOS:

Pagesa e pesë anetareve (ligjerues, anetar ndihmes, etj),. me shumë 215.00 €

Dreka sipas projektit LOGOS (per 8 Mars-Dita e gruas) me shumë 162.20 €

Pagesat e kontratave ne veper per QKMF:

Kontrate ne veper – moter medicionale 290.00 €;

Pagesat e kontratave ne veper per UNDP-Roje Pyelli, nje roje nga Kaçaniku dhe një nga Hani i Elezit pasi qe projekti eshte i perbashket. 2x250.00 = 500.00 €.

Pagesave e dhuratave te vitit te ri me shume 2,475.00 € (DPT. ”Preni Commerce” – H.Elezit)

Pagesa e Shtrimit me kubeza te rruges se tregut e mbetur borxh nga viti 2010 si neglizhence e organizates LOGOS, ku me arsyetim na u kane drejtuar per pagese ne shume prej 1,800.00 € (NTP.”ARBRINI”Ferizaj)

Furnizim me llaptopa, projector, TV etj per zyren e Kuvendit me shume 9,541.00 € (NSH. “Ceti Computers” – H.Elezit).

Pagesa e fatures per Dy (2) publikime gazeta KOSOVA SOT me vlere 232.00 €.

Pagesa e borxhit 2011 (gusht-nentor 2011) reklama dhe konkurse për gazetën Info Press me shumë 748.56,

Pagesa e fatures per reklama dhe konkurse per Janar 2012 me shume 67.77 €.

Transporti I hemodializes per muajin Janar 2012 me shume 434.72 €,

Pagesa per mbushjet Vala e mbetur borxh nga viti 2011 - Zyra e kuvendit 120.00 €, Transferet per Organizaten Caritas I Luxembourgit per bashkefinansim per fsh.Seqishte 20,000.00 €;

Mbushjet Vala per zyren e kryetarit, zyren e kuvendit dhe drejtorive per muajin Mars-prill 2012:

Shuma e pergjithshme per furnizim me mbushje vala eshte 740.00 €,

Mbushje sipas projektit per barazi gjinore - 20.00 €;

Pagesa e gazetes zyrtare – 18.00 €;

Pagesa per kontraten ne veper per muajin mars per moter medicionale – 290.00 €

Pagesa e certifikatave te gjendjes civile sipas kontrates se Ministrise se Puneve te Brendshme – 390.00 € .

Pagesa e rojeve te pyellit sipas projektit te UNDP-se per muajin mars 2012, nje nga Kaçaniku dhe nje nga Hani i Elezit 2x 250.00 € = 500.00 €;

Pagesa e romingut te kryetarit me shume 79.42 € (VALA)

Jane zhvilluar procedura te ofertave dhe nenshkrimi I kontrates per:

Furnizim me kamera per shkollat e Hanit te Elezit dhe eshte kryer Nenshkrimi I kontrates per Furnizim me kamera, per 3 shkollat fillore dhe shkollen e mesme. (NSH.CSC-EU- Ferizaj) financuar nga FIQ deri 5,500.00 €, kurse diferenca tjetër që tejkalohet është obligim i komunës.

Eshte kryer procedura dhe eshte nenshkruar kontrata per piketimin nderkomunal Hani I Elezit – Kaçanik sipas projektit me UNDP-ne (NSH.”Geodata”-Kaçanik) me vlere 9,910.00 €.

Eshte kryer procedura dhe eshte nenshkruar kontrata per Botimin e Vjetarit 2011- Komuna Hani I Elezit (shtypshkronja”ERA”-Ferizaj) me shume 2,125.00 €,

Muaji Prill 2012

Gjatë muajit prill kemi zhvilluar procedura të ndryshme sipas kompetencave që kemi si zyre e prokurimit:

Kemi zhvilluar procedura me urdhërblerja të vjetër dhe procedura tjera sipas ligjit në fuqi.

Gjate ketij muaji janë zhvilluar procedura të prokurimit si:

Përgatitja e njoftimit për kontratë për KRPP, punimi i dosjes së tenderit për Rregullimin e rrugicës te Lagjja e Krasniqëve me kubëza betoni, ku është zhvilluar procedura e prokurimit,në muajin prill do të bëhet vlerësimi i ofertës.

Është shpallur në KRPP njoftimi për kontratë dhe është punuar dosja për ”Asfaltimin e rrugës së Pustenikut”;

Është kryer procedura për Furnizim me material higjienik për komunë, shkolla, QKMF dhe agjensionin pyjor komunal etj, është hapur oferta është vlerësuar.

Është kryer procedura për furnizim me material (zyrtar) dhe material të shtypur për nevojat e komunes, shkollave, QKMF-së etj, dhe është nënshkruar kontrata një vjeçare sipas çmimit per njësi/copë,

Është kryer procedura për Transportin e nxënësve të shkollës Ilaz Thaçi (Kashan-Uji i Tharte-Hani i Elezit dhe anasjelltas dhe Krivenik – Hani i Elezit dhe anasjelltas) dhe është nënshkruar kontrata me shume mujore 900.00 €, Kurse gjatë muajit prill janë kryer këto pagesa pasi që janë mbajtur katër /4 mbledhje si në vijim:

Pagesa sipas kontratave në vepër sipas projektit Logos – Zyra për Barazi Gjinore, me shume 645.00 €

Mbushje Vala për barazi gjinore 60.00 €,

Pagesa e darkes per zgjedhjen e sportistit me te mire te vitit, me shume 300.00 €.

Është kryer pagesa për "Furnizim me material për mirëmbajtjen e veturave" VW "DPT" H. Elezit me shumë prej 422.00 € + 509.00 € = 931.00 €

Është kryer pagesa për Vaj për ngrohje për shkolla nga Drejtoria e Arsimit (borxh i 2011) me shumë 8,133.15 € (NTP. "Bubeari Commerce" Kaçanik),

Është kryer pagesa e derivateve për Shëndetësi me shumë 700.15 €, (NTP. "Bubeari Commerce"-Kaçanik),

Është kryer pagesa e derivateve për administratën komunale (per muajte janar dhe shkurt 2012) në shumë prej 4,004.90 € (NTP. "Bubeari Commerce" – Kacanik),

Është kryer pagesa e borxhit vaj për ngohje për QKMF me shumë prej 2109.75 €, (NTP. "Bubeari Commerce"-Kacanik),

Është kryer procedura e Furnizimit me 2 sharra motorr sipas projektit të UNDP-së me shumë prej 990.00 € (PPZ. "SHTILL" – Ferizaj),

Pagesa e trajnuesve dhe stafit tjetër prej 5 anëtareve sipas projektit LOGOS për Barazi gjinore me shumë: 215.00 € ;

Ushqim dhe pije për takimet sipas projektit LOGOS per Barazi gjinore 100 € .

Pagesa e kontratës në vepër sipas projektit të UNDP-së (Roje Pyelli) për dy rojtar 2x250.00 = 500.00 €

Është kryer obligimi (borxhi i murit mbrojtës) të rrugës së Dimcës në shumë prej **26,492.00 €**, shpk. Eskavatori Ferizaj.

Pagesa e byfes komunale ne shumë prej 877.30 €

Eshte kryer procedura e prokurimit per vjetarin 2011, ku eshte kryer kontrata dhe eshte paguar lenda ne shume 2,125.00 €

Pagesa e certifikatave te gjendjes civile sipas kontrates nga MPB-ja per Furnizim me certifikata ne shume prej 390.00 €

Muaji Maj 2012

Gjatë muajit maj kemi zhvilluar procedura të ndryshme sipas kompetencave që kemi si zyre e prokurimit:

Kemi zhvilluar procedura me urdhërblertje të vjetër dhe procedura tjera sipas ligjit në fuqi.

Gjate ketij muaji janë kryer keto procedura te pagesave:

- Pagesa e obligimit AZHR-Lindje 500.00 €,
- Derivate per Zyren per barazi Gjinore 60.00 € (shpk. "Bubeari Petrol" Kaçanik)

Pagesa e ligjërueseve dhe anetareve sipas projektit për Barazi Gjimore – LOGOS (ligjëruesve dhe anetareve të komisionit) me shumë 215.00 €.

Koktejt sipas projektit për Barazi Gjimore - 100.00 € (NT. ARDI – Hani i Elezit)

Pagesa e rojeve të pyellit sipas projektit të UNDP-së (dy roje pyelli) 2x 250.00 = 500.00 €;

Transporti i nxenesve të sh.f. "Ilaz Thaçi" – Hani i Elezit për muajin 05 Prill – 05 Maj :

➤ Kashan-Uji i Tharte Hani i Elezit – 500.00 € (NT.Elita Tours-Kaçanik)

➤ Krivenik – Hani i Elezit – 400.00 € (NT. Elita Tours – Kaçanik)

Mbushje Vala sipas projektit LOGOS:

➤ Zyra për barazi gjimore – 20.00 €

Pagesa e romingut të kryetarit në shumë prej 38.84 € (VALA),

Kontrata në veper për moter medicinale me shumë 290.00 €,

Transporti i personave me hemodialize për 2 muaj (shkurt-mars 2012) – 869.44 €.

Pagesa për mirembajtjen dimerore të rrugëve të Hanit të Elezit (sipas projektit

Rikonstruim i rrugëve lokale) 9,980.00 € - shpk. "Eskavatori"-Ferizaj,

Shpenzimet e varrimit për banoret e Komunes së Hanit të Elezit sipas marrëveshjes me Bashkesinë Islame Hani i Elezit: 3,060.00 € - Bashkesia Islame H.Elezit

Nafte për QKMF-Hani i Elezit – pagesa për vaj për ngrohje janar 2012 me shumë 3,199.84 € shpk.Bubeari Petrol – Kaçanik

Mirembajtja e veturave zyrtare :

➤ Vetura Hyundai Santafe - 147.00 €

➤ Dy (2) Veturat Toyota – 1,290.00 €

➤ Kontrata në Veper për prerës të pyellit sipas projektit të UNDP-së për shenjezim H.Elezit – Kaçanik, këtu kanë marr pjesë (2 motorist, 2 ndihmes-motorist dhe 2 pastrues terreni); shumë e pagesës 1,600.00 €;

Pagesa për mbushjet vala sipas departamenteve; zyra e kryetarit, zyra e kuvendit, drejtorive etj:

➤ 740.00 € - Vala 900

Pagesa e lëndës për Furnizime mjekësore sipas projektit 1,100.00 € - Litografia Gjakovë, (borxh 2011).

Pagesa e lëndës për "Furnizim me kalendarë, notesa, lapsa kimik dhe shkrepesa për K.Hani I Elezi" me shumë 6,000.00 € (NTP. "PROMIX" Ferizaj).

Muaji Qershor 2012

Zyra e prokurimit ka zhvilluar procedurë konform ligjit në fuqi për prokurim publik.

Gjate muajit qershor janë kryer keto pagesa:

Pagesa për pije për muajin maj për Byfen SAFETI në vlerë prej 892.70 €;

Pagesa e projektit te meremetimit te parkut te shkolla fillore "Ilaz Thaçi"- 1,997.50 € NTP. "Arti" Pozheran-Prishtinë (sipas projektit LOGOS);

Pagesa e rojeve te pyellit sipas projektit per shenjezim nderkomunal Hani i Elezit – Kaçanik, pagesa $2 \times 250.00 = 500.00$ € (sipas marreveshjes nje roje pyelli nga Kacaniku dhe nje nga Hani I Elezit)

Pagesa e derivative te naftes sipas projektit LOGOS per Barazi Gjinore 117.91 € (NTP. Bubeari Commerce- Kaçanik),

Pagesa e transportit te nxenesve sipas kontrates "Transporti i nxenesve nga Kashan-Hani I Elezit dhe anasjelltas" 500.00 € , dhe "Krivenik-Hani I Elezit" dhe anasjelltas 400.00 €.

Pagesa e shpenzimeve te takimeve per ushqim dhe pije sipas projektit LOGOS per Barazi Gjinore ne shume 100.00 €.

Furnizim me mbushje Vala sipas projektit per barazi Gjinore LOGOS – me vlere 20.00 €;

Pagesa e ligjeruesit per Barazi Gjinore sipas bashkepunimit Komune-LOGOS– 90.00 €;

Pagesa e lendes per Shenjezimin (ndarjen kadastrale) nderkomunal Hani i Elezit – Kaçanik sipas projektit te UNDP-se – vlere e projektit 9,910.00 € (NSH. "GeoDATA"- Kaçanik).

Pagesa e naftes per administraten komunale dhe derivate per mirembajtjen e varrezave te Deshmoreve 1,944.55 € sipas kontrates me NTP. Bubeari Commerce-Kaçanik.

Pagesa e lendes borxh i vitit 2011 sipas kontrates se Ministrise se Shendetesise per Furnizim me material shtypes shendetesor me shume 178.00 € (shpk. "EUROPRINTY-Prishtine).

Pagesa e disa lendeve per sigurimin dhe regjistrimin e veturave te administrates komunale, QKMF-se, zjarrfiksave dhe zyres pyjore komunale.

Kamioni Mercedes (dhurate e KFOR-it Gjerman) – vlere e regjistrimit dhe taksave tjera 523.80 €;

Kamioni IFA (kamion i vjeter) – vlere e regjistrimit dhe taksave tjera me shume 391.64 €;

Xhipi (Landrover) i agjensionit pyjor komunal – vlere e regjistrimit dhe taksave tjera – 305.80 €;

Xhipi (Toyota i administrates komunale) – vlere e regjistrimit dhe taksave tjera – 340.60 €

Pagesa per tre anëtarë sipas projektit LOGOS per Barazi Gjinore, me shume 45.00 €:

Pagesa sipas projektit te UNDP-se (dy roje pyelli dhe dy inspektuesve te projektit) $2 \times 250.00 = 500.00$ € dhe $2 \times 300.00 = 600.00$ € shuma totale 1,100.00 € ;

Procedurat e prokurimit qe jane zhvilluar :

Zhvillimi i procedures per "Shtrimin me kubeza te rruges Ura e Fejzes-Rrafshe-meliq dhe Punimi i kanalizimit" ne bashkepunim me MPMS, ketu hyn zhvillimi i procedures sipas Ligjit te Prokurimit, Publik Njoftimi i KRPP per Kontrate, punimi i dosjes se tenderit, dergimi i dosjeve operatoreve ekonomik, kurse me date 29.06.2012 eshte bere hapja e ofertes per projektin ne fjale.

Nenshkrimi i kontrates ”Shtrimi me kubeza betoni i rruges nga Lagja e Krasniqeve deri te shkolla K.Diturise – Paldenicë” me shume **29,724.00 €**.

Kryerja e procedurave te Hapjes, vleresimit dhe shpalljes se fituesit ne KRPP per projektin e ”Asfaltimit te rruges se Pustenikut”vlera e projektit **492,994.62 €** .

Zhvillimi i procedures per “Furnizim me medikamente per QKMF-Hani i Elezit”, hapja e ofertave, vlerësimi i ofertave sipas çmimit për njësi/copë.

Zhvillimi i procedures për **Sigurimin dhe regjistrimin e veturave te administrates komunale, QKMF, Zjarrfiksave dhe Agjensionit pyjor komunal**, hapja e ofertave, vleresimi I ofertave dhe shpallja e fituesit sipas çmimit për njësi/copë.

- ZYRA LIGJORE -

Zyra ligjore e cila është në organogramin e komunës e radhitur nën ombrellën e zyrës së Kryetarit të Komunës gjatë gjashtëmujorit të vitit 2012, ka vazhduar punët dhe detyrat në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe udhëzimeve të tjera nga ana e eprorit, përkatësisht nga Kryetari dhe bashkëpunimi me Drejtorët e drejtorive dhe me zyrtarë të tjerë. Si zyre kemi bashkëpunuar me të gjithë sektorët e komunës dhe jemi munduar që pajtueshmëria e akteve të drejtorive komunale të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) zyra ligjore gjatë gjashtëmujorit 2012 në afatin e paraparë ligjor ka dërguar të gjitha vendimet e aprovuara të Kuvendit të Komunës me shkresë përcjellëse, të parapara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Pas miratimit të vendimit nga ana e Kuvendit të Komunës 31.01.2011 për ngritje të padisë kundër AKP-së për shitjen e ndërmarrjes “Sharr Cem” pa procedura të hapura dhe në mënyrë të kundërligjshme dhe dorëzimit në Gjykatën Supreme, në dhomën e veçantë me dt.08.04.2011 është dorëzuar padia me gjithë dokumentacionin e duhur në këtë Gjykatë dhe deri në momentin e raportimit përveç se e kanë pranuar lëndën tonë, nuk kemi informacione zyrtare për ndonjë procedim të mëtutjeshëm.

Gjithashtu kemi paraqitur edhe një kërkesë për shqyrtim të Ligjshmërisë dhe të Kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese për këtë çështje, e cila është në shqyrtim të kësaj Gjykate, por ende nuk kemi ndonjë vendim.

Kurse me rastin e dorëzimit të lëndës për emrin e Komunës në gjuhën serbe kërkesa me nr.02/176 dt.30.03.2011, Gjykata Kushtetuese për këtë çështje ka marrë vendim në Janar të 2012, me të cilin kërkesa jonë për shqyrtim të Ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë është shpallur e papranueshme vendimi është në Ueb faqen e Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë këtij gjashtë mujori kemi pasur **19** lëndë gjyqësore kryesisht padi kundër komunës së Hanit të Elezit.

Prej tyre **11** janë për vërtetim të pronësisë

3 për dëme materiale,

2 për pengim posedimi,

- 1 për masë të përkohshme,
- 1 për Lirim të paluajtshmërisë,
- 1 propozim për ekzekutim të borxhit.

Të gjitha llojet e padive janë brenda Kosovës, me përjashtim prej 3 padive janë nga nacionaliteti romë, (për dëme materiale), të cilët para lufte kanë jetuar në territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

Si rezultat i këtyre lëndëve një rast prej tyre është mbyllur në favor të komunës, kurse rasti i fundit ekzekutimi i borxhit është bërë me marrëveshje, me tërheqje të padisë pasi borxhi është paguar. Për të gjitha llojet e padive duke respektuar Ligjin për procedurën kontestimore kemi bërë prapësime procedurale me përgjigje në padi, në afatin ligjor, përfaqësimin e tyre me autorizim nga ana e Kryetarit të Komunës sipas ftesës së Gjykatës Komonale dhe procedurat e tjera ligjore.

Në komisionin disiplinorë kemi pasur një rast për shkelje disiplinore dhe ndaj tij pas zhvillimit të procedurave janë bërë të gjitha hetimet brenda dhe jashtë institucionit dhe janë marrë masat disiplinore konform rregullave në fuqi, (degradimi, ulje e pozitës dhe koeficientit).

Kurse në komisionin për shqyrtimin e ankesave për tatimin për pronën e paluajtshme tani në shqyrtim kemi 31 prej tyre dhe jemi në procedurë të vlerësimit në teren dhe më pas palëve sipas Ligjit të TP, do ju lëshohet nga një vendim për aprovimin apo refuzimin e ankesave. Gjithashtu kamë marrë pjesë në komisione të intervistuese dhe me shkrim gjatë pranimit të kandidatëve, hapjen e disa ofertave në fushën e prokurimit, kurse tani jemi komision për klasifikimin e vendeve të punës, për të gjithë shërbyesit civil qe të komunës së Hanit të Elezit.

Kemi vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal dhe atë të Shërbimeve Publike, në fushën e ligjshmërisë të akteve Ligjore dhe nënligjore.

Kjo zyrë ka bërë edhe pajtueshmërinë e akteve ligjore në Komunë nëpër sektorë dhe kemi dhënë disa komentime lidhur me dispozitat e Ligjeve, Rregulloreve apo Udhëzimeve Administrative. Kemi pasur edhe seminare dhe trajnime të fushave të ndryshme, 2 takime me kolegjiunin e zyrtarëve ligjor të komunave të Kosovës dhe një takim pune e kemi pasur në Tiranë për klasifikimin të vendeve të punës për shërbyesit civil, sipas Ligjit të shërbimit Civil dhe Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës.

Zyra ligjore ka hartuar një numër të vendimeve, ankesave, përgjigje në kërkesa, urdhëresa, autorizime, marrëveshje të mirëkuptimit, marrëveshje të veçanta të shërbimit, kërkesa, Përgjigje në padi dhe akte të tjera të ngjashme.

Shumicën e këtyre akteve do t'i paraqes në muaj siç vijojnë:

Muaji Janar 2012

Dorëzimi i vendimeve të Kuvendit të Komunës në MAPL- për Ligjshmëri (6)	
Përgjigje Kërkesa	4
Vendime	5
Kallëzim penal.....	1
Interpretime Ligjore në MAP...	1
Njoftime	2
Marrëveshje të veçanta	2

Shkurt

Vendimet e Kuvendit të Komunës për muajin shkurt (6)	
Përgjigje në Kërkesa	9
Vendime	3
Propozim vendime	3
Kërkesë për rritje të pagave për stafin politik (drejtuar Asociacionit të Komunave)	1
Kërkesë për Interpretim Ligjor në MAP	1
Kërkesë për Interpretim ligjor në MAPL.....	1
Takim me Kolegjiunin e Zyrtarëve Ligjor.....	1

Mars

Vendimet e Kuvendit të Komunës për muajin mars (8)	
Vendime	4
Përgjigje në kërkesa..	8
Urdhëresa.....	5
Përgjigje ne ankesa...	2
Seancë Gjyqësore	1
Dalja në vendngjarje..	1

Prill

Vendimet e Kuvendit të Komunës për muajin Prill (1) dhe 1 rregullore	
Vendime	2
Përgjigje në Padi	1
Përgjigje në kërkesë	4
Kërkesë për historiat të pronave	2
Takim me Kolegjiunin e zyrtarëve Ligjor..	1

Maj

Vendimet e Kuvendit të Komunës për muajin Maj (7)	
Përgjigje në kërkesë	3
Përgjigje në Padi	9
Seanca Gjyqësore	3
Njoftim për ndërrim destinimin e tokës bujqësore	1
Vendime	3
Autorizime	2

Qershor

Vendimet e Kuvendit të Komunës për muajin Qershor (2)	
Vendime	3
Përgjigje në Ankesë	3
Përgjigje në Padi.....	9
Përgjigje në Kërkesa	7
Seanca Gjyqësore	3
Përgjigje në Kërkesë ndaj Auditorëve	1
Seanca Gjyqësore	5
Dalja në vendngjarje	3

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Veprimtarinë dhe aktivitetin e punës, DAP-i e ushtron duke u bazuar në kornizën ligjore si vijon:

- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale;
- Statuti i Komunës së Hanit të Elezit;
- Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale
- Ligji mbi procedurat administrative nr. 02/L-28;
- Ligji për Emrin Personal nr. 02/L-118
- Vendime, urdhëresa dhe rregullore tjera të nxjerra nga organet komunale

Aktivitetet e drejtorisë së administratës për gjashtëmuajorin e parë 2012

Drejtorja e administratës së përgjithshme për periudhën JANAR –QERSHOR-2012 aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e objektivave të cilat i ka parashtruar vetes në bazë të kompetencave dhe planit të punës për vitin 2012 .

Në fillim të muajit janar është bërë unifikimi i librave të protokolit, kalimin nga protokoli klasik në atë elektronik.

Instalimi i teleprezencës në sallën e Kuvendit

Përgatitja e planit të punës 2012 të Drejtorisë së Administratës

Kamë punuar në përgatitja e raportit të punës për vitin 2011

Drejtorja e administratës është angazhuar në përgatitjen e rregulloreve që dalin nga ky sektor dhe sektoreve tjera .

Takime me Caritasin e Luksemburgut rreth projekteve në fshatin Seçishtë .

Takime me asosacionin e kolegjiut të Drejtorëve të Administratës

Bashkëpunimi me komunat e Republikës së Kosovës e sidomos me komunën amë të Kaçanikut.

Pjesëmarrja në takimet e rregullta me Kryetarin si dhe pjesëmarrja ne mbledhje të Kuvendit dhe KPF-së

Takime me zyrtar te MPB rreth hapjes se zyrës për regjistrimin e automjeteve dhe patentë shofer

Pjesëmarrja ne debat Publik

Drejtoria e administratës gjatë kësaj periudhe ka pasur tri vizita sudimore në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi të organizuar nga Akademia mbi Vetëqeverisje Lokale, si dhe një vizitë në Shqipëri te organizuar nga KS Kosova .

Takime me organizata të ndryshme USAID, LOGOS, UNHABITAT-it, si dhe me KFOR-in

Drejtori i Administratës ka pasur takime me punëtorët e sektorit rreth punëve dhe probleme të këtij sektori, kurse rregullisht gjatë orarit të punës janë vizituar punëtorët nëpër zyre .

Pjesëmarrja në takimin e Kryetarit me përfaqësuesit e fshatrave

Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative si dhe furnizim me tonerë për nevoja të administratës komunale .

Furnizim i administratës komunale me material higjenik .

Jam angazhuar në përgatitjen e manifestimeve të 17 shkurtit dhe 11 qershorit .

Dorëzimi i raporteve çdo muaj në Entin e Statistikës së Kosovës dhe në departamentin e regjistrimit civil në Prishtinë

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur disa studentë që kanë mbajtur praktikë në Komunë .

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme përbëhet nga katër sektorë. Sektorët që operojnë në kuadër të

DAP-së janë:

1. Shërbimi i Gjendjes Civile (SHGJC)
2. Qendra për shërbim të qytetarëve (QSHQ)
3. Shërbimi i Arkivit dhe TI-së dhe
- 4 . Autoparku (AP)

1. Shërbimi i Gjendjes Civile (SHGJC):

Ky shërbim operon me një zyre të Gjendjes Civile në ndërtesën Komunale në përbërje prej dy zyrtarëve .

Në Zyrën e Gjendjes Civile në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, janë lëshuar gjithsej **2550** dokumente

nga SHGJC, duke përfshirë dokumentacionin e Gjendjes Civile si dhe dokumente (certifikata,

vendime, vërtetime, etj) sipas kërkesave të palëve.

Zyra e ofiqarisë edhe këtë vit një angazhim të veçantë ka pasur në ripërtrirja e librave të gjendjes civile (librat të cilat janë asgjësuar nga pushteti serb) .

Shprehur në shifra ky shërbim ka kryer këto shërbime për palë;

<i>Gjithsej</i>	<i>Çerte. Lindjes</i>	<i>Çerte. Martesë</i>	<i>Çerte. St.Mart.</i>	<i>Çerte. Vdekje</i>	<i>Çerte. B.familia</i>	<i>Çerte. Jete</i>	<i>Çertif. e çbatacic</i>	<i>Vërt. M.mat.</i>	<i>Konfirmim</i>	<i>Dëshmi e</i>	<i>Vërt.Ud hatimi</i>	<i>Çertifikat</i>	<i>Të tjera</i>	<i>Totali</i>
	1048	301	122	58	158	43	447	16	5	24	3	323	2	2550

Janar – Qershor/ 2012

1. Aktvendime për regjistrim të më vonshëm në LAL.....5
2. Aktvendime për regjistrim të vdekjes në LAV.....3
3. Aktvendime për ndryshimin dhe përmirësimin e emrit dhe mbiemrit...10
4. Aktvendime për harmonizimin e datës së lindjes dhe vdekjes.....1
5. Vërtetime mbi fitimin e shtetësisë së Kosovës.....2
6. Aktvendim për anulim për regjistrim në LAL

2. Qendra për shërbim të qytetarëve (QSHQ):

Ky sektor i DAP-it aktivitetin e vet e bazon kryesisht në pranimin e kërkesave nga qytetarët dhe shpërndarjen e atyre kërkesave nëpër drejtori – zyrat përkatëse si dhe pranimin e përgjigjeve (vendimeve) nga këto drejtori – zyra me qëllim të shpërndarjes së tyre deri tek qytetari i cili ka parashtruar kërkesë.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2012 në QSHQ janë pranuar gjithsej **4.418**, duke përfshi edhe kërkesa për zyrën e regjistrimit civil .

Lëndë (kërkesa) të cilat ende nuk kanë marrë përgjigje dhe të cilat gjenden në procedurë janë gjithsej **46** lëndë .

Numri dhe struktura e lëndëve (kërkesave) të pranuar dhe përgjigjet (vendimet) e kthyera, sipas drejtorive-zyrave në këtë gjashtëmuor 2012, është si vijon:

DREJTORITË	Kërkesa të pranuar Janar-Qershor 2012	Lëndë të përfunduara Janar-Qershor 2012
Kuvendi Komunal	56	52
Zyra e Kryetarit	210	210
D. e Administratë	2937	2936
D.Buxhet dhe financa	199	196
D.Shërbime Publike dhe Emergjencë	38	9
D. BPZHR	27	24
D. Zhvillim Ekonomik	0	0
D. Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje Mjedisit	813	811
D. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	44	40
D. Arsim Kulturë Rini e Sport	82	82
Zyra e prokurimit	12	11
TOTALI :	4.418	4.372

Të hyrat që krijohen në DAP, bazohen në rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale. Ato gjatë periudhës Janar-Qershor 2012, janë realizuar në vlerë prej **7.617.00 €** duke mos llogaritur ato kategori të cilat sipas vendimit komunal janë të liruar nga taksa.

3.Shërbimi i arkivit

Zyra e arkivit e komunës së Hanit të Elezit në përputhje me obligimet që dalin nga ligji për arkivimin e dokumenteve zyrtare gjatë vitit 2012 ka vazhduar me sistemimin, arkivimin si dhe me asgjësimin e dokumenteve jo arkivore.

Sistemit të intranetit si dhe ndërlidhja e këtij sistemi përmjet skanerit digjital ka mundësuar zyrën e arkivit dhe administratën komunale që të ketë pasqyrë shumë më të mirë në rrjedhjen e dokumenteve si dhe arkivimin e tyre në mënyre elektronike.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 përmes këtij sistemi drejt zyrës së arkivimit elektronik janë regjistruar gjithsej xxxx lëndë prej të cilave janë arkivuar 2870 lëndë me gjithsej 770 dokumente të ndryshme. Arkivimi elektronik i dokumenteve është aplikacion <https://e-arkiva.rks-gov.net> i cili menaxhohet nga MAP-ja.

- **Teknologjia informative:**

- Bashkëpunim i ndërsjellë me MAPL në mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e serverëve dhe rrjetit
- Hapja e emailave zyrtar për zyrtarët e Administratës komunale
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e kompjuterëve në institucionet e Komunës së Hanit të Elezit

4. Shërbimi i Autoparkut (AP):

Administrata Komunale posedon gjashtë vetura të gjitha janë në gjendje të mirë .

- Ky shërbim edhe gjatë kësaj periudhe ka bërë ndarjen e veturave për zyrtarët sipas nevojave dhe kërkesave që paraqesin, mbikëqyr urdherudhetimet, plotësimin e tyre.
- Ka bërë servisimin dhe mirëmbajtjen sipas nevojave, regjistrimin dhe sigurimin, pastrimin .
- Furnizimi me derivate percjell hargjimeve të derivateve dhe llogaritjen e kilometrave per çdo muaj.

DEPOJA

Depoja ka vazhduar me furnizimin me material për Administratën Komunale sipas planit dhe nevojave si dhe shpërndarjen e materialit në bazë të kërkesave të zyrtarëve të miratuara nga Kryetari si dhe ka bere regjistrimin e materialit .

Ka vazhduar furnizimi me inventar dhe pajisja tjera për nevoja në Administratën Komunale, si dhe është bërë barkodimi i tyre dhe shpërndarja sipas kërkesave .

Raporti i punës së zyrës së transparencës për periudhën Janar-Qershor 2012

Në përputhje me planin e aprovuar të veprimit për vitin 2012, zyra e transparencës aktivitetin e vet e ka zhvilluar në kryerjen obligimeve në fushën e informimit publik sa më të mirë si të qytetarëve të komunës ashtu edhe opinionin sa më të gjerë për të gjitha aktivitetet që kishin të bëjnë me zhvillimet në komunën tonë.

Në vazhden e aktiviteteve që kanë dalë nga këto obligime zyra e për transparencës ka bërë informimet dhe njoftimet me kohë që dalin si obligime ligjore nga Rregullorja për transparencë , duke organizuar debate publike tematike, në të cilën janë debatuar rregullore të dala nga Kuvendi i Komunës për diskutime publike , takimet Kryetarit të Komunës me qytetarët , dëgjimet publike për planifikimet buxhetore dy prej të cilave janë është organizuar në bashkëpunim me LOGOS-n .

Duhet të theksohet se në të gjitha këto tubime pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e kënaqshme duke iu mundësuar të jenë të informuar me kohë për të gjitha zhvillimet në komunë në mënyrë që edhe ata të jenë pjesë e këtyre zhvillimeve.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 në komunën e Hanit të Elezit ka pas shume ngjarje dhe zhvillime te cilat zyra e informimit ju ka prezantuar qytetarëve të komunës sonë por edhe opinionit me te gjerë me mbi 80 postime ne faqen zyrtare te komunës së Hanit të Elezit, me shkrime ne mjetet e informimit publik ,për të përmendur, Kohën Ditore ,Zërin, Kosova Sot ,si dhe gazetate tjera ditore te shkruara por edhe ato elektronike si televizionet RTK, Klan Kosova, KTV ,Tv Liria, Tv Tema ,Radio Kosova dhe konsiderojmë se është arritur prezantim i mirë i komunës sonë para opinionit të gjerë sidomos kur të merret parasysh se të gjitha këto informata kishin karakter afirmativ .Vlen të theksohet se Web-Faqja zyrtare e komunës deri në muajin qershor ka pasur 14509 shikime.

Në përputhje me Ligjin për qasje në dokumente publike 03/L-215 dhe udhëzimeve administrative përcjellëse zyra për informim është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe raportimin periodik të zbatimit të këtij Ligji .

Ne gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 komuna e Hanit të Elezit ka pasur katër kërkesa për qasje në dokumente publike të cilat kanë marrë përgjigjeje në afatet e parapara ligjore.

Në fushën e teknologjisë informative zyra për informim është angazhuar për aspektet teknike për zbatimin dhe realizimin e projektit të monitorimit me anë të Teleprezencës.

Në këtë periudhë kohore kemi pasur një gjendje stabile të funksionimit të sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë informative dhe nuk kemi pasur as një defekt që do të kushtëzonte intervenime jashtë institucionit të komunës.

Raport i punës së zyrës së Qendrës Kryesore të Regjistrimit Civil

Kjo zyre ka dy zyrtar të cilët janë punëtorë të Administratës Komunale të cilët janë caktuar në bazë të marveshjes së bashkëpunimit në mes MPB dhe Komunës së Hanit të Elezit .

Kjo zyre bënë lëshimin e dokumentacioneve si : Pasaporta Biometrike dhe Letërnjoftime të Republikës së Kosovës

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të raportit të QKRC-së

Shprehur në shifra ky shërbim ka kryer këto shërbime për palë;

Nr		Të pranuar për periudhën Janar-Qershor/ 2012	Të shpërndara në periudhën Janar-Qershor 2012	Të pa përfunduar në periudhën Janar – Qershor 2012
1.	Pasaporta Biometrike	424	422	2
2.	Letërnjoftime të Republikës së Kosovës	328	324	4
3.	Totali	752	746	6

Të hyrat që janë mbledhur në QKRC gjatë kësaj periudhës janë realizuar në vlerë prej **13.700.00€** .

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për buxhet dhe financa prej periudhës janar – qershor 2012 aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e aktiviteteve dhe objektivave të cilat i ka parashtruar vetes dhe kompetencave që i ka në planin e punës për vitin 2012.

Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e shpenzimeve të buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Drejtoria për buxhet dhe financa si objektiva prioritare ka pasur , përmbushjen e të gjitha obligimeve legjislative që rrjedhin nga dispozitat ligjore të nivelit qendror , atij komunal dhe nga statuti i miratuar i komunës në përgatitjen dhe hartimin e dispozitave ligjore , si dhe zbatimin e tyre.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur takime me Ministrinë e Financave , me Asociacionin e Komunave të Kosovës me Drejtorët për Buxhet dhe Financa të të gjitha komunave, organizatat e ndryshme si AZHR-në, Logos intercooperation, Caritasin e Luksemburgut .

Kemi pasur dy takime jashtë vendit në Shqipëri, njëri për përgatitjen e buxhetit për shërbime sociale me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe tjetrin me zyrtaren për barazi gjinore me organizatën Logos lidhur me përgatitjen e buxhetit edhe për barazi gjinore.

Në kuadër të Drejtorisë për buxhet dhe financa veprojnë këta sektorë;

- Sektori i buxhetit
- Sektori i thesarit – pagesave
- Sektori i tatimit në pronë
- Sektori i inspektimit të tregut , komunikacionit dhe biznesit.

Sektori i buxhetit – gjatë këtij viti ky sektor ka pasur një mori aktivitete:

- Përgatitja e propozim vendimit për bartjen e bilanceve të pashpenzuara të vitit 2010 dhe tejkalimit të të hyrave vetanake të vitit 2011 në vitin vijues 2012 në shumë prej 87,958.30 € .

- Përgatitja e raportit final të konsoliduar dhe analitik të bilancit të gjendjes dhe raporteve financiare për vitin 2011 për organizatën buxhetore të komunës dhe përgatitja e pasqyrave financiare për vitin 2011 për zyrën e Auditorit gjeneral.

Gjatë muajit shkurt kemi pasur një takime me qytetarët e komunës për raportin e shpenzimeve për vitin 2011 dhe një dëgjim publik në muajin qershor për shpenzimet janar –qershor 2012 dhe planifikimet 2013-2015 të ndihmuar nga Logos intercorporation.

- Përpilimi dhe përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore , me zotimet dhe shpenzimet e parashikuara të mjeteve buxhetore sipas dinamikës së planifikuar për vitin 2012 nëpër të gjitha kategoritë ekonomike si : paga dhe meditare, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe shpenzime kapitale.

- Përgatitjet për propozim vendim për rishikimin e buxhetit, ku kemi pasur ndryshime të projekteve kapitale në shumë prej 108,000 €..

- Përgatitja e draftit të Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për periudhën 2013-2015 , sipas qarkores buxhetore 2013/01 të lëshuar nga Ministria e Financave .

Drejtori i drejtorisë për punën e vet dhe të drejtorisë në përgjithësi, ka raportuar para Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në baza javore, mujore dhe gjashtëmujore, dhe sipas nevojës edhe në periudha tjera, atëherë kur është kërkuar një gjë e tillë.

Sektori i thesarit – pagesave - ky sektor sistemin e pagesave, të hyrave dhe dalurave e ka të instaluar me një program të nivelit qendror të Ministrisë së Financave i ashtuquajturit Sistem i Informatave mbi Menaxhimin Financiar të Kosovës (SIMFK).

Gjate kësaj periudhe gjashtëmujore ka pasur këto aktivitete :

- Përpunimi , harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave dhe të dalurave buxhetore sipas programeve buxhetore , fondeve dhe kodeve ekonomike .

- Përgatitja për barazimin me thesarin për tremujorin e shpenzimeve, barazimin mujor, tremujor me të hyrat vetanake dhe alokimin e tyre nëpër projektet kapitale.

- Mbjajta e evidencave të sakta dhe shtimi i efikasitetit në arkëtimin dhe bankimin e pagesave – inkasimet në arkë , depozitimet bankare , transferim i të hyrave komunale dhe alokimin e këtyre mjeteve nga fondi i BQK-së dhe të hyrave vetanake.
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave nga granti qeveritar të destinuar për pagesën e pagave dhe mëditjeve, të këshilltarëve komunal dhe komiteteve të ndryshme.
- Tërheqja e avanseve të parave te gatshme të “pety cash-it” për programet buxhetore dhe rimbushjet e tyre sipas kërkesave dhe vendimeve të miratuara në shumën e limituar të pagesave të faturave deri në shumën nën 100€.

Sektori i tatimit në pronë – gjatë kësaj periudhe kjo zyre ka pasur këto aktivitete:

- Kryerja e të gjitha punëve organizative , informative dhe zbatimi i formave më efikase për përfshirjen sa më të mirë të zonave tatimore dhe për fillimin e punës për vitin 2012, me programin e propozuar dhe të furnizuar nga Ministria e Financave.
- Regjistrimi dhe mbajtja e saktë e pagesave të realizuara dhe evidentimi i borxheve nga tatim-obliguesit për periudhën e deritanishme 2012(kalkulimi i kamatave dhe ndëshkimeve) krahas operimit me të dhënat me softuer , mbajtja e të dhënave të posaçme në Excel.
- Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 31 ankesa prej qytetarëve ku janë në fazën e shqyrtimit nga bordi i ankesave te tatimit në pronë.
- Është përgatit propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të tatimit në pronën e paluajtshme.
- Të hyrat nga tatimi në pronë për vitin 2012, faturimi ka qenë 72,524.82€, kurse janë arkëtuar 30,490.76 €, që do të thotë se janë realizuar 42,08% nga faturimi dhe borxhet.

Sektori i inspektimit të tregut , komunikacionit dhe biznesit – gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar në inspektimin e subjekteve afariste, kontrollimin e aktvendimeve për pranim teknik për ushtrimin e bizneseve dhe lokaleve – hapësirës së punës , në pengimin e ushtrimit të veprimtarive nga tregtarët joformal dhe në largimin permanent të shitësve në rrugë dhe trotuare të cilët merren me veprimtari tregtare (gjatë ditëve të tregut).

Gjatë kësaj periudhe inspektori i biznesit ka inspektuar shumicën e lokale afariste ku 16 prej tyre ka dhënë vërejtje dhe sugjerime si në : kafiteri, sallone të ondulimit, furra të bukës, pompa të derivateve, lojëra të fatit (bastore sportive).

- Në këtë vit është miratuar rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale, ku kemi pasur zbritje 20% për të gjitha bizneset nga kuvendi i komunës.
- Është bërë përgatitja e aktvendimeve mbi ngarkesat vjetore për vitin 2012 të mbështetur në rregulloren mbi taksat, tarifat dhe ngarkesat komunale, ku numri i aktvendimeve të lëshuara ka qenë 303 aktvendime për ngarkesat vjetore

Gjatë këtij viti inspektori i tregut,biznesit dhe komunikacionit ka kryer këto punë:

- vazhdimi i 24 lejeve për punë për auto – taxi
- lëshimi i 6 kërkesave për pëlqime teknike të lokaleve
- dënime mandatore kemi pasur 1 rast
- inspektime me procesverbale ka pasur 25 për subjektet afariste .

KERKESAT E QYTETARËVE NDAJ DREJTORISË PËR BUXHET DHE FINANCA

Gjatë kësaj periudhe drejtorisë për buxhet dhe financa iu kanë paraqitur **157** kërkesa , ku prej tyre 126 janë shqyrtuar , kurse 31 kanë mbetur në shqyrtim e sipër nga bordi i ankesave të tatimit në pronë.


- 31 kërkesa nga tatimi në pronë
- 6 kërkesa për pranime teknike për lokale afariste
- 24 kërkesa për leje auto-taksi
- 25 vërtetime për bursa për student
- 35 vërtetime për subvencione
- 36 vërtetime të ndryshme .

TË HYRAT E DREJTORISË PËR BUXHET DHE FINANCA PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2012/11 – krahasimi

Nr	Përshkrimi	2012	2011	Krahasimi	Përqindja
1	Të hyrat nga tatimi në pronë	30,490.56	33,966.62	3,476.06	89.77
2	Të hyrat nga regjistrimi i veturave	7,660.00	8,300.00	640.00	92.29
3	Të hyrat nga ngarkesat vjetore	15,722.00	59,405.00	43,683.00	26.47
4	Të hyrat nga pranimet teknike	895.00	1,430.00	535.00	62.59
	Totali	54,767.56	103,101.62	48,334.06	53.12

Në raport me gjashtëmujorin e vitit 2011, të hyrat e Drejtorisë për buxhet dhe financa për vitin 2012 kanë shënuar një zbritje prej 48,334.06 € apo **46.88%**

TË HYRAT SIPAS GRAFIKUT



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

PLANIFIKIMET

Drejtoria e shërbimeve publike ka punuar në sistemimin dhe rregullim e defekteve të ujësjellësit që ka pas me pak probleme gjatë këtyre gjashtë muajve në krahasim me vitin e kaluar.

Në këtë periudhë gjashtë mujore të vitit jemi munduar që të bëjmë punën tonë në sigurimin e ujit të pijes për të gjithë shfrytëzuesit e ujësjellësit të Gllloboqices, dhe që nga prilli shfrytëzuesit e këtij ujësjellësi mund të përdorin ujin për pije dhe amvisëri.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në kuadër të qeverisjes së mirë në planin e saj të menaxhimit të performances së komunave, në komunën tonë koordinator dhe menaxhues të këtij sistemi është drejtori i DSHPE-së për mbledhjen dhe futjen e të dhënave në sistem për menaxhimin e performances së komunës në bashkëpunim me zyrtaret e certifikuar për këtë lëmi dhe nga kjo punë e bërë komuna jonë ka marr një shpërblim nga USAID në vlerën prej 45.000 \$ (dollarë amerikan).

PUNË, AKTIVITETE DHE TAKIME TË NDRYSHME

Drejtori i shërbimeve publike dhe emergjence civile është anëtarë i këshillit komunal për siguri në bashkësi KKSB ku këto takime mbahen të premtën e fundit të muajit nga ora 14:00.

Drejtoria për shërbime publike në kuadër të aktiviteteve të planifikuara me planin e veprimit të KKSB-së për vitin 2012 ka realizuar fushatën vetëdijesuese për sigurisë në komunikacion, ku projekti është financuar nga organizata SAFERWORLD.

Janë realizuar keto aktivitete në kuadër të fushates vetëdijesuese për siguri në komunikacion. Me datë 26-27.03.2012 :-Vendosja e billbordave, vendosja e tabelës me porosi të nxënësve, aktiviteti sportiv në pingpong për femra- finalja, aktivitet sportiv futboll për meshkuj- finalja, shenjëzimi i zebrave në qytet, ligjërata –kujdesi në trafik në shkollën “Ilaz Thaqi”, ekspozita e nxënësve të shkollës fillore “Ilaz Thaqi” në këtë shkollë.

Me datën 22.05.2012 kemi bërë edhe pranimin e **390** kontenjerve nga Caritasi i Luxemburgut në kuadër të përfitimit të donacionit të fshatit Seçishtë.

24.05.2012 DITA E PASTRIMIT TA PASTROJMË KOSOVEN

Pjesëmarrësit në këtë aksion për pastrim ishin: komuna e Hanit të Elezit, QKMF-ja, Shkolla fillore “ Ilaz Thaqi” me 4 paralele ku si ato në fshatin Seçishtë, fshatin Kryenik, fshatin Laq dhe Pusët e Nikes, shkolla fillore “Keshjtjella e Dituries”, Shkolla fillore “Veli Ballazhi”, shkolla e mesme “Dardania”, Ekipet vepruese për siguri EVSB-të,

Sharr Cem Hani i Elezit, Kompania ndërtimore KRASI, Policia e Kosovës, ndërmarrja Higjiena, ndërmarrja Pastërtia, OJQ, etj.

Në aksion ishin afër 1200 pjesëmarrës, ku kanë pastruar 95% të asaj të cilën kishim planifikuar, 9 tonë mbeturina.

ELEMINIMI I DEFEKTEVE NË UJESJELLES DHE KANALIZIM

Drejtoria e shërbimeve publike kemi rregulluar apo eliminuar defektet që kanë ndodhur në ujësjellësin e komunës tonë.

Defekteve të eliminuara në ujësjellësin e Hanit të Elezit na kanë përcjell edhe këtë vit.

Po ashtu kemi bërë pastrimin e kanalizimit atmosferik dhe atij fekale aty ku kemi pas probleme (kanalizimi i Paldenicës dhe Hanit të Elezit).

SHKRESATE TË PRANUARA DHE TË LESHUARA NGA DSHPE

Në gjashtëmujorin e parë drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjence civili janë bërë këto shkresa por dhe janë lëshuar nga drejtoria e DSHPE-së.

Nga numri i total i shkresave për gjashtë mujorin e vitit 2012 është :-

• Urdhëresa te ndryshme-	06
• Vërejtje të ndryshme	10
• Kërkesë KEK-ut	01
• Përgjigje në kërkesë	03
• Leje të ndryshme	07
• Pranim të kërkesave për vendosjen e panove	02
• Pëlqime për pano reklamuese	02
• Intervenime të zjarreve të ndryshme	17

TË HYRAT NË SHERBIME PUBLIKE NGA PANOT REKLAMUESE

Të hyrat nga panot reklamuese apo billboard-at dhe pagesa të tjera për gjashtë mujorin vitit 2012 në drejtorinë shërbimeve publike janë në vlerën prej: 5,040.00 €

Gjithsej të hyra në drejtori janë : 5,120.00 €

SHËRBIMI I ZJARRFIKËSVE –SHZSH-

Më 14.05.2012 shtëpia e zjarrfikës dhe shpëtimit ka marr donacion nga KFOR-i Gjerman një kamion për shuarjen e zjarrit i cili ka performanca të mira për punë.

Duhet thënë se kamionin ekzistues tani e kemi arritur që ta rregullojmë dhe të funksionoj për nevojat e SHZSH dhe themi se momentalisht SHZSH-ja numëron dy kamion për shuarje të zjarreve.

Trajnimet

Në fillim të viti drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjence harton planin për trajnimin e zjarrfikësve me qëllim të arritjes së profesionalizimit të zjarrfikësve të komunës së Hanit të Elezit.

Deri më tani me ftese të Qendrës së Trajnimeve në Vushtrri kemi trajnuar një zjarrfikës në trajnim e zjarreve fushore dhe malore, vlen të theksohet edhe trajnimi i drejtorit të DSHPE-së i cili është trajnuar në planifikim emergjent.

Trajnimet të tjera do të vazhdojnë konform planit të trajnimeve dhe organizimit të qendrës për trajnime të avancuara në Vushtrri.

Me propozim të drejtorisë së DSHPE-së kryetari i komunës ka marre vendim për formimin e grupit punues për hartimin e planit të vlerësimit të rrezikut në territorin e komunës së Hani të Elezit.

Gjate këtij gjashtëmujorit të vitit 2012 kemi intervenuar 17 herë , nga këto intervenime janë intervenime fushore, malore, objekte private.

Në vijim kemi disa të dhëna për intervenimet e SHZSH.

INTERVENIMET E SHZSH -së

Intervenime në objekte private	6
Intervenime në objekte shoqërore	0
Intervenime në zjarre fushore	7
Intervenime në zjarre malore	3
Intervenime në impiantet elektrike	0
Intervenime në vërshime.....	0
Intervenime në komunikacion.....	0
Intervenime tjera.	1

Gjithsej intervenime për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012

Janë : 17 (shtatëmbëdhjetë) intervenime.

Kemi pas edhe shërbime tjera qytetarëve si: mungesë uji dhe hapje kanalizimi.

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Drejtoria e e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është munduar që gjatë këtij gashtëmujori aktivitetet e veta ti zhvilloi në bazë të legjislacioneve në fuqi, statutit të komunës ku kjo drejtori obligohet ti kryen detyrat dhe obligimet e saj si dhe ti respektoj afatet e aplikimit për subvencionimin e bujqëve në sektor të ndryshëm, ndihmesën e fermerëve në lehtësimin e aplikimit për subvencionim nga ana e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Objektivat e DBPZHR-së

Objektivat tona janë këto;

- Mbrotja e tokave bujqësore nga degradimet;
- Inkurajimi i fermerëve në zhvillimin e bujqësis dhe blegëtorisë;
- Mbrotja e pyjeve nga prerësit ilegalë si dhe zjarret;
- Rrespektimi i afateve për apkimim të fermerëve për subvencionim nga MBPZHR-ja;

Aktivitetet e DBPZHR-së

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë këtij viti kemi pasur takime në MBPZHR , si dhe me Organizaten KDC Gjakova, HAIFER KOSOVO, AZHR Lindje, Organizaten Botërore e Punës ILO e cila mirret me mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda, bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës –Fakultetin e Bujqësis dhe Veterinarisë, bashkëpunimi me DBPZHR-në Kaçanik në programin e EUred-Projekti për Zhvillimin e Turizmit Rural në Regjionin e Lindjes ku implementimin e këti projekti e bënë komuna e Ferizajt në bashkëpunim me Organizatën T-Consulting ku ndihmë dhe kontributë të madhë ka dhënë Drejtori i Zhvillimit Ekonomik nga Hani i Elezit si dhe Drejtori i DUKMM nga Kaçaniku në përcaktimin e parces për vendosjen e qendrës informuese për turizëm rural që gjendet në Kashan përgjatë magjstralës Hani i Elezit - Kaçanik, ku në të ardhmën pritet që të rritet interesi në zhvillimin rural ,të bëhet meremetimi i tri apo katër shtëpive ku në të ardhmen do të shërbejn si bujtina për turistat që kanë dëshirë të vijnë dhe të vizitojn fshatërat e komunës tonë, natyren e bukur, gryken e lumit Lepenc, gryken e Prockës së Laçve, fushën e Gorancës, varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës si dhe shumë vende atraktive që ka vendi ynë.

Takimet dhe trajnimet me zyrëtarët nga të gjitha komunat e Kosovës dhe fermerët e Hanit të Elezit të organizuara nga Ministrin e BPZHR-së dhe OJQ-të
Gjatë këtij gjashtëmujori kemi marrë pjesë në takime të ndryshme, trajnime si dhe aktivitete të ndryshme të organizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me KDC Gjakova (Kosovo Develop Center), ku KDC Gjakova është fituese nga Ministria e BPZHR-së për mbajtjen e trajnimeve të fermerëve në komunën tonë gjatë muajve Maj, Qershor e vazhdon deri në Dhjetor, Organizatën

ILO, T Consulting, HAIFER Kosova, Shoqatën “Drenusha” nga Hani i Elezit, USAID Kosova.

Gjithësej janë organizuar 6 trajnime, 13 takime, 3 punëtori :

- 3 trajnime me organizatën KDC Gjakova për zyrtarët
- 2 trajnime me ILO-në Organizata Botërore e Punës
- 1 trajnim me Organizatën Haifer Kosovo
- 3 takime me T Consulting
- 2 takime me Haifer Kosova
- 2 takime me anëtarët e shoqatës “Drenusha” Hani i Elezit
- 1 punëtori të organizuar nga MBPZHR-ja
- 1 punëtori të organizuar nga HAIFER Kosova
- 4 takime me grupin e hartimit të PLVM-Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
- 1 punëtori me grupin e hartimit të PLVM-Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

Është bërë pasimi i dhuratës nga anëtarët e Shoqatës “Drenusha e cila udhëhiqet dhe menaxhohet nga Organizata HAIFER Kosova për 5 fermerë të rinjë ku kanë përfshi fshatin Paldenicë në pasim për këtë vitë (saktësisht më datën 19.04.2012) ku është shapallur fermeri më i mirë dhe Shoqata “Drenusha” nga Hani i Elezit si shoqata më e mirë në gjithë Kosovën dhe kanë fituar si fermer më i mirë 156,20 \$ (dollar amerikane) si dhe Shoqata më e mirë 585,40\$ (dollar amerikan)

Llojet e kërkesave, urdhëresave, njoftimeve etj.:

- 2 kërkesa për ndërtim të një miniferme të dhijëve
- 2 kërkesa për hulumtim dhe eksploatim të gurit gëlqeror
- 4 urdhëresa për dalje të komisionit në vendin e ngjarjes
- 5 njoftime për CARITAS LUXEMBURG
- 2 njoftime për aplikim në grandet për subvencionim nga MBPZHR 50%-50%(ndertimi i shtallave të reja për lop dhe pula si dhe pemë, perime dhe vreshta)
- 3 njoftime për subvencionim nga MBZHR (dele dhe dhijë, bletë si dhe lopë qumështore)
- 4 njoftime (informata) tjera të ndryshme (aplikim për pretje të pyjeve private, KDC Gjakova, T Consulting dhe përcaktimi i kombastëve për korrje-fshirje 2012)

Të hyrat në DBPZHR gjatë gjashtëmujorit të parë 2012 janë gjithsejtë 800€, (dalja e komisioneve në teren, dhe dhënia e pëlqimeve)

Spektori i Bujqësisë dhe Blegtorisë:

Në spektorin e Bujqësisë jemi munduar t’iu ndihmojmë fermerëve për aplikim për subvencionim të fermerëve nga Ministria e BPZHR-së për dele, dhi, bletë dhe lopë

qumështore si dhe në sektorin agro rural në bashk investime 50%-50%, ku nga ky projekt në komunën tonë kemi vetëm një aplikues.

Gjatë gjashtëmujorit të parë kemi dorëzuar në Ministrinë e BPZHR-së :

- Subvencionim për bletë 14 aplikime
- Subvencionim për mbjellje vjeshtore 20 aplikime
- Subvencionim për lopë 58 aplikime
- Subvencionim për dele dhe dhijë 14 aplikime
- Subvencionim 50%-50% në sektorin agrorural (ngritje të një pemishteje) 1 aplikim

Në regjistrin e fermerëve në listat e NIF(Numri Identifikues i Fermerëve) në kuadër të Republikës së Kosovës nga komuna jonë janë të regjistruar 73 fermer ku nga ta 2 janë femra.

Lista e përfituesëve për të gjithë fermerët në të gjitha kategorit mund të jetë e gatshme në muajin Shtator për arsye se në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë duke kontrolluar fermerët që kanë aplikuar në subvencionim dhe grande për bashk investime 50%-50%.

Sektori i Zhvillimit Rural-Turizmit

Në këtë sektorë kemi filluar në projektine Zhvillimit të Turizmit në Regjionin Lindje të financuar nga Unioni Evropian dhe të menaxhuar nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë dhe të implementuar nga Kuvendi Komunal i Ferizajt në partneritet me komunat e regjionit lindje: Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Klllokot, Shtërpca, ku këtë projekt e kanë ndarë në tre zona bashkëpunimi që do të cekim më poshtë:

- Ferizaj dhe Shtërpca
- Kaçaniku dhe Hani i Elezit si dhe
- Viti dhe Klllokoti

Ne si partner në këtë projekt me komunën e Kaçanikut kemi bërë përcaktimin e pikës për informim që gjendet në lagjen e Kashanit (Te Ura e Kashanit anën e majt) përgjat magjistralsë Hani i Elezit-Kaçanik, ku kjo parcele është pronë P.SH.Ekonomisë Pyjore dhe e K.K. Kaçanik në zonën kadastrale Gjurgjedell. Në këtë pikë kemi marr rekomandime se këshilla të mira nga zyra në Ferizaj që bën implementimin e këtij projekti ku si parcele i plotëson kushtet infrastrukturore (rruga, rryma dhe uji) për vendosjen e kësaj qendre informuese turistike.

Ky projekt do të zgjatë 22 muaj dhe është e ndarë në katër faza deri në përfundimin e projektit.

Katër fazat janë:

1. Identifikimi i pikave turistike (shtëpiave për banim), përcaktimi i dy koordinatorëve nga dy komunat –Hani i Elezit dhe Kaçaniku
2. Përcaktimi i parces për pikën informuese dhe 2 udhëheqësve të qendres informuese

3. Vendosja e qendres informuese turistike
4. Promovimi i produkteve bujqësore,artizanale

Gjatë këtij gjashtëmujori kemi kryer aktivitete të ndryshme ku do ti cekim veç e veç për secilen në tabelën e mëposhtëme në të gjithë sektoret.

Nr.	Emërtimi	Miratuar	Në	Refuzua	Paguara	Pa paguar	Totali gjedheve,deleve,dhijëve	Shqyrtimi i kërkesave	Totali
1	Kërkesë për prerje private të pyjeve	59	0	0	-	-		APK-Ferizaj	59
2	Kërkesa të mëvonshme për prerje private të pyjeve		2	0	-	-		APK-Ferizaj	2
3	Kërkesë për ndërrim destinim të tokës	0	0	0	0			K.K. Hani i Elezit	0
	Kërkesë për subvencionim për dele nga MBPZHR-ja	7					695		7
4	Kërkesë për subvencionim për dhijë nga MBPZHR-ja	7	0	0			208	Agjencion i pagesave MBPZHR	7
5	Kërkesë për subvencionim për blete mbi 20 bletë MBPZHR-ja	6		8			150	Agjencion i pagesave MBPZHR	14
6	Kërkesë për subvencionim në bashkë-investime (pemë,perime dhe vreshta)		1					Agjencion i pagesave MBPZHR	1
7	Fletëparaqitje për prerje ilegale	36						Gjykata Komunal për Kundërvaj	36

								tje Kaçanik	
8	Fletëparaqitje për prerje ilegale	4						Prokuroris ë Publike Komunale -Ferizaj	4
9	Kërkesë për subvencionim nga MBPZHR (mbjellje vjeshtore-grurë)	18	0	2	0	0	0	Agjencion i i pagesave MBPZHR	20
10	Kërkesë për shfrytëzim të tokës-ndërtim të miniferms	2						K.K. Hani i Elezit Agjencioo ni Pyjor - Prishtine	2

Sektori i Pylltarisë:

Mbrojtja e pyjeve; Gjatë pjesës së parë të këti viti janë ngritur 46 fletëparaqitje:

- Fletëparaqitje në Prokurorin Publike në Ferizaj 3, në një sasi prej 14.36m³ dhe një shumë prej 1.376.82 euro kurse
- Fletëparaqitje në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Kaçanik 43 me një sasi prej 49.11m³ ose në 5.703.22 euro, ku prej tyre janë realizue gjashtë fletëparaqitje në procedur të shpejt ku kryesishtë janë transporte ilegale.Konfiskimi i masesës drusore; Janë konfiskuar 20.30m³ dru nga transportet ilegale ose shtatë traktorë prej tyre janë ngritur pesë fletëparaqitje ndërsa dy ju janë marrur vetem drutë

Pyjet private; Gjithsejtë janë pranuar 61 kërkesa për prerje në pyje private , kemi formuar komisionin për shqyrtimin e të gjitha kërkesave për dorzimin e tyre në Agjencionin Pyjor në Ferizaj për procedura të matutjeshme ku prej gjitha këtyre kërkesave deri në muajin Qershor janë realizuar 26 është bërë damkosja e trungjeve në pyje private.

Shënjëzimi vijës kadastrale (kufitare) në mes të komunës Hanit të Elezit dhe Kaçanikut: Gjatë këti gjashtëmujori kemi bërë shënjëzimin e vijës kadastrale në mes të komunës së Hanit të Elezit dhe Kaçanikut ku si komuna partnere kemi fituar projektin për “Shënjëzimin e vijës kadastrale” ku kemi punësuar 2 roje pylli,2 motorrista(drurë prerës) dhe 4 ndihmësa të motorristave (ndihmës drurë prerës) nga projekti i UNDP.Projektin në tërësi nuk kemi arritur ta realizojm për shkaqe se nga Agjencioni Pyjor i Kosovës nuk na është lejuar hapja e vijës sipas kontatës të cilën e

kishte fituar kompania dhe në atë pjesë ku ishin pyjet më të larta nuk është lejuar të prerja e tyre.

Zjarret: Gjatë këtij gjashtëmujori të parë në teritorin e Hanit të Elezit nuk kemi pasur dy raste të zjarrit në rajonin e fshatit Krivenik .

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Detyrat e drejtorisë së zhvillimit ekonomik për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 kanë qenë të fokusuar në përmbushjen e planit të punës të paraqitur në fillim të këtij viti. Këto detyra që do të paraqiten më poshtë kanë për qëllim arritjen e vizionit të drejtorisë së zhvillimit ekonomik i cili vizion është i orientuar në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me rritje të kapaciteteve industriale, zhvillim i qëndrueshëm rural si dhe promovim të turizmit.

AKTIVITETET E DREJTORISË

Pasi që planet zhvillimore komunale janë detyra obligative për një menaxhim më të mirë të komunës dhe buxhetit që ajo posedon, komuna është munduar që strategjinë e vetë të zhvillimit ta drejtoj duke respektuar këto plane.

Detyrë tjetër e kësaj drejtorie është koordinimi dhe bashkërendimi në përputhjen e strategjive komunale me strategjitë rajonale dhe kombëtare , ku vlenë të përmendet iniciativa e përbashkët e shumë komunave së bashku me komunën tonë në projektin e përbashkët për fondet e Bashkësisë Evropiane, ku implementues është AZHR (Agjensioni për zhvillim rajonal). Në këtë projekt jemi nënshkrues të partneritetit me komunat tjera, në projektin e zhvillimit të turizmit rajonal, ku fituesi i këtyre graveve është edhe komuna jonë.

Ekipi i Projektit të Zhvillimit të Turizmit në Regjionin Lindje , i cili është i financuar nga Unioni Evropian, menaxhuar nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Kuvendi Komunal i Ferizajit në partneritet me Komunat e Kacanikut , Vitise , Hanit të Elezit , Shterpcës dhe Klllokotit kanë identifikuar aktivitetet që do të do të zhvillohen në këtë projekt si më poshtë:

- Përcaktimi i pikave turistike dhe shenjësive tyre në komunën tonë
- Përcaktimi i një pike të përbashkët midis komunës tonë dhe komunës së Kaçanikut, ku do të bëhet vendosja e një objekti që do të informon turistët.
- Caktimi i shtëpive mikëpritëse për turistët

Komuna jonë, në përgjithësi dhe drejtoria ime në veqanti përveq investimeve nga grandet qeveritare, të cilat janë shumë të limituara bënë një angazhim të palodhshëm në thithjen e donacioneve nga donatorët e ndryshëm siq janë Logosi, Caritas, Luxemburg, IOM, Care internacional , ku jemi në përgaditjen e disa projekteve të cilat

do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë, si në aspektin social dhe atë ekonomik.

Komuniteti i fshatit Seçishtë i përfaqësuar nga këshilli i fshatit në bashkëpunim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorinë për Shërbime Publike, duke identifikuar nevojat e komunitetit në fushën e mbrojtjes së ambientit, ka nxjerrë si prioritet furnizimin e familjeve me kontejner për grumbullimin e mbeturinave. Në mbështetje të këtij aktiviteti Caritasi i Luksembourgut dhe komuna e Hanit të Elezit për komunitetin e fshatit Seçishtë financuan projektin për kontejner familjarë 125 l, të cilat janë shpërndarë falas për familjet e fshatit Seçishtë ku vlera e përgjithshme e këtij projekti është 10.500.00 €. Gjithashtu nga Caritas Luxemburg jemi në përgatitje e sipër për projektet në fondet e tyre për periudhën 2011-2013 dhe atë në dy kategori : Projekte regjionale dhe projekte të komuniteteve.

Pjesë e punës së kësaj drejtorie ka qenë edhe bashkëpunimi me drejtorin e buxhetit dhe financave në hartimin e qarkores buxhetore 2013-2015, si dhe planifikimit për investime kapitale.

Në mars të këtij viti kemi pasur takim me Usaid-in në Prishtinë së bashku me zyrtarin e pylltarisë z. Bela për mundësin e investimeve në ndihmë komunitetit të Hanit të Elezit nga kompania Sharrcem, ku nga ana e Komunës janë dhënë fushat kryesore në të cilat mundë të investohet dhe atë në blegtori, bujqësi dhe pylltari.

Në kuadër të projektit të financuar nga EU për „Zhvillimin e Turizmit në Regjionin Lindje të Kosovës” komuna e Ferizajt si bartëse e projektit dhe komuna e Hanit të Elezit si partnere në këtë projekt ku edhe jemi nënshkrues të „Memorandum Mirëkuptimit” për zhvillimin e turizmit në Regjionin Lindje të Kosovës, kemi pasur takim në Ferizaj ku janë prezentuar objektivat e projektit dhe roli i komunave në implementimin e këtij projekti.

Gjithashtu kemi pasur takim pune me Caritas Luxembourg për përzgjedhjen e laptopit dhe videoprojektorit për shkollën e fshatit Seçishtë. Aty kanë marrë pjesë pos zyrtarëve komunal edhe përfaqësuesit e fshatit, më pas kemi vazhduar takimin me grupin e gjenerimit të të hyrave ku kemi diskutuar konceptet bazë të këtij sektori.

Në këtë muaj Zyrtari për zhvillim ekonomik ka qenë në trajnim për zyrtar të rigjistrimit të pasuris.

Në prill kemi hapur ofertat në shëdetëdetësi, për gjenerator dhe monitor, si dhe në fushën e ambientit kemi hapur ofertat për kontanjer.

Takimi me Heiferin dhe përfaqësues të zyres franceze, ka rezultuar me shpalljen e fermerit më të mirë që bashkëpunon me këtë organizatë z. Qamil Kalisi.

Në prill kemi bërë përcaktimin e kriterëve për projektin gjenerimi i të hyrave në blegtori, bujqësi dhe bletari.

Në muajin maj kemi vazhduar që të kemi kontakte me donatorët për këtë vit, ku aktivitetet konkrete janë :

Në maj kemi pasur takim me T-Consulting, udhëheqës të projektit të turizmit për caktimin e koordinatorit për zhvillim rural.

Gjithashtu kete muaj kemi bere hapjen e ofertave per Bletë dhe sera ne Ferizaj se bashku me Caritas Luxembourg-un.

Zyrtari për zhvillim ekonomik z. Nazim Luri dorëzon të hyrave vetanake në bankë, dhe atë në baza ditore. Më poshtë do të japim tabelën e të hyrave vetanake të dorëzuara nga zyrtari.

Të hyrat vetanake të dorëzuara në bankë nga zyrtari i zhvillimit ekonomik z. Nazim Luri

Nr	Muaji	Vlera euro
1	Janar	1049.00
2	Shkurt	895.00
3	Mars	2059.00
4	Prill	1693.00
5	Maj	1687.00
6	Qershor	1714.00
	Totali	9097.00

ANALIZA DHE KONTROLLI I AKTIVITETEVE

Aktivitetet planifikuara	Koha e aktivitetit	Vendi i aktivitetit	Rezultatet e pritura	Rezultatet e arritura
Implementimi i projekteve nga Caritas Luxemburg dhe komuna në projektin e komunitetit të fshatit Seqishtë	Janar 2011-dhjetor 2013	Fshati Seqishtë	Arsim,shëndetësi,gjenerim i të hyrave etj	Shëndetësi (gjenerator,Ekg pajisje), Ambient (Furnizimi me kontenjer) Gjenerim i të hyrave (furnizimi me lopë,sera dhe bletë) Arsim (monitor dhe laptop,fotokopjues,faza përgaditore për Qendër Kulturore,kënd të lojrave,nxemje qendrore,fushë sporti) Gjini (kursi i rrobaqepësisë)
Identifikimi, rifreskimi dhe përpilimi i Listave të Projekteve Prioritare të nivelit të lartë në sferën e investimeve kapitale	Qershor-gusht 2012	Komuna Hani i Elezit	Realizimi I projekteve prioritare	Është bërë rifreskimi i prioriteteve në listën e projekteve. Janë inicuar procedurat për fillimin e projektit : ”Asfaltimi i rrugës se

				Pustenikut"vlëra e projektit 492,994.62 € .
Vazhdimi i aktiviteteve në ndërtimin e infrastrukturës komunale me qëllim të zhvillimit të sekt. ekonomik	Janar-dhjetor 2012	Komuna Hani i Elezit	Staf profesional në sektorë ekonomik	Ngecje për shkak të buxhetit të limituar në kategorinë e pagave.
Koordinimi dhe bashkërendim për përputhjen e strategjive të Komunës me strategjitë rajonale dhe kombëtare	Janar-dhjetor 2012	Komuna Hani i Elezit	Harmonizimi I ligjeve dhe rregulloreve në nivelin qendror dhe lokal	Përmes AZHR së jemi fitues të projektit regjional për turizëm rural.
Hartimin e projekt politikave në ndihmë të zhvillimit ekonomik të Komunës dhe biznesit	Janar-mars 2012	Komuna Hani i Elezit	Rishikimi I rregulloreve në të mirë të biznesit	Ulja e taksave për biznes dhe lirimi nga taksat për biznese të reja.
Koordinim në hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për PZHK dhe strategjitë sektoriale në nivel Komune	Janar-dhjetor 2012	Komuna Hani i Elezit	Zhvillimi I sektorëve	Zhvillimi i sektorit të bujqësisë me projektin e gjenerimit dhe subvencionet nga ministria e bujqësisë dhe komuna.
Monitorimi i zbatimit të PZHK dhe koordinim i monitorimit të zbatimit të strategjive sektoriale në nivel Komune	Janar-dhjetor 2012	Komuna Hani i Elezit	Harmonizimi mes sektorëve	Gjatë aplikacioneve në fondet e ndryshme marrin pjesë zyrtarë nga drejtori të ndryshme.
Inkurajim dhe promovim i zgjerimit të bizneseve dhe sipërmarrjes në Komunë kryesisht të SME-ve	Janar-dhjetor 2012	Komuna Hani i Elezit	Shtimi i bizneseve të reja e sidomos SME-ve	Projekti i gjenerimit të të hyrave ka ndihmuar 48 familje në mundësinë e shtimit të bizneseve të reja
Ofrim dhe nxitje të përmirësimit të shërbimeve të Komunës ndaj biznesit Inkurajim, mbështetje	Janar-dhjetor 2012	Komuna Hani i Elezit	Afatet e shkurtëra kohore për shërbime ndaj	Komuna e Hanit të Elezit për të dytin vit me radhë është në top-performuesit më të mirë në Kosovë në kuadër të Programit të

dhe menaxhim i programeve e projekteve në mbështetje të biznesit			biznesit	USAID-it „Indeksin e Konkurrencës në Komuna” për përmirësimin e mjedisit afarist.
Mundësim i marketimit dhe promovimit të Komunës dhe potencialeve të saja	Janar-dhjetor 2012	Komuna Hani i Elezit	Informacione për biznes në faqen zyrtare	Në „Raportin e Kosovës për Indeksin e Konkurrencës në Komuna 2012” (IKK) komuna e Hanit të Elezit rradhitet si e dyta, duke u potencuar si performuese e fuqishme në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për përmirësimin e mjedisit afarist.

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

-Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit pranë Komunës Hani i Elezit është e organizuar në dy sektorë :

1. Sektori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
2. Sektori i Kadastrit

-Në kuadër të DUKMM-së janë të punësuar shtatë (7) zyrtarë të cilët sigurojnë funksionimin normal të Drejtorisë në përputhje me ligjet aktuale në fuqi.

U R B A N I Z M I

I Planifikimi

- 1. Hartimi i planeve rregulluse Urbane(PRRU):** - Pas përfundimit të PZHK-së dhe PZHU-së apo marrjes së Pelqimit nga MMPH vitin e kaluar (14.07.2011) për PZHK dhe miratimin e PZHK/PZHU nga Kuvendi Komunal Hani i Elezit, në fund të muajit nëntor 2011 është arritur marrëveshja për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit z.Rufki Suma dhe UN-HABITAT-it për Hartimin e PRRU-së për një pjesë të Zonës Urbane të qytetit, saktësisht njësia Qendra dhe njësia Parku.

Në muajin shkurt 2012 kemi pas një takim me grupin punues për hartimin e planeve rregulluese urbane (PRrU), ku kemi bërë ndarjen e detyrave për hartimin e planeve rregulluese. Jemi duke punuar në fazën e vlerësimit të gjendjes ekzistuese, futjen e të dhënave dhe punimin e hartave me GIS sistem.

Përfundimi I hartimit të këtyre planeve rregulluese për dy zonat e përmendura më lartë parashihet të përfundohet në afat kohor dy vjeçar.

II Projektet Kapitale Investive

Në vazhdimësi kam qenë i angazhuar në të gjitha projektet investive kapitale duke kontribuar në:

- Përgatitjen e Aplikacion projekteve dhe paramasave dhe parallogarite për projektet të ndryshme në këtë periudhë siç janë:
 - Rregullimi i trotuarit dhe rrugës për këmbësor nga lagja e Krasniqëve deri tek shkolla fillore “Kështjella e Diturisë”-Paldenicë (Projekti dhe Aplikacion Projekti për LOGOS).
 - Rehabilitimi i rrugës, ndërtimi i kanalizimit fekal dhe stabilimenti i dheut në lagjen Rrafshe-Meliq”-shtrimi me kubëza betoni i rrugës (revidim i projektit dhe përgatitja e projekt aplikacionit për MPMS)
 - Përgatitja e paramasës dhe parallogaritë për shtrimin e rrugës në fsh. Krivenik.
 - Shtrimi me kubëza betoni për disa rrugica-trotuareve të qytetit,
 - Projekti i fushës së sportit në fshatin Seçishtë (për CARITAS)
 - Projekti i rregullimit të shtratit të proçkës në fshatin Seçishtë (për CARITAS)
 - Furnizimi me kontinier në qytetin e Hanit të Elezit (Paramasë dhe parallogarit dhe projekt aplikacion për LOGOS)
 - Si dhe përgatitja e paramasave dhe parallogarite tjera dhe projekt aplikacioneve të ndryshme që kanë qenë dashtë të dorëzohet tek donatori për përzgjedhje (LOGOS, EURED, MPMS, UNDP, MAPL...) etj.
- Mbikëqyrjen e punimeve në teren dhe ndihma punëkryesit në realizimin e projekteve,
- Përgatitjen së raporteve përfundimtare (narrative) për LOGOS (rreth projekteve të realizuara), dhe raporteve tjera për UNDP etj.

Më poshtë po japim listën e projekteve investive kapitale të planifikuara si dhe statusin e tyre momental:

#	EMRI I PROJEKTIT	DONATORI DHE ADRESA	BUXHETI I PLANIFIKUAR	ORGANIZATA QË E ZBATON PROJEKTIN DHE ADRESA	STATUSI I MOMENTAL I PROJEKTIT	KOHËZGJATJA
1	Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit - Gorancë	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	2,348,816 €	"ARBOTEC" - Prishtinë	Në fazën e realizimit	Viti 2010-2012
2	Asfaltimi i rrugës Lagja e Re - Pustenik	MAPL K.K.Hani i Elezit	492,994.62 €		Në fazën e tenderimit	Viti 2012-2013
3	Rikonstruimi i rrugës Ura e Fezës-Rrafshe - Meliq	MPMS K.K. Hani i Elezit	130.000.00 €		Ne fazën e tenderimit	Viti 2012
4	Rregullimi i rrugës prej lagjes së Krasniqëve deri tek Sh.f. "Kështjella e Diturisë"	LOGOS - Intercooperation	23,809.20 €	Zuka Commerce Gjilan	Në fazën e realizimit	Viti 2012
		K.K. Hani i Elezit	5,944.80 €			
		Gjithsej:	29,754.00 €			
5	Punimi i murit mbrojtës në rrugën e Dimcës	K.K. Hani i Elezit	26,492.00 €	Eskavatori	Ka përfunduar	Viti 2011-2012
6	Salla e sportit tek shkolla fillore "Ilaz Thaçi"	Komisioni Evropian	300,000.00 €	TEHNOBETON – Zagorje, Kroacia	Në Fazën e realizimit	Viti 2011-2012
7	Instalimi i stacionit për monitorim të përhershëm të ndotjes së ajrit.	MMPH	90,000.00€	MMPH	Ka përfunduar	Viti 2011-2012
8	Shtruarja dhe sanimi i rrugëve (mirëmbajtja dimërore)	K.K. Hani i Elezit	10,000.00€	Eskavatori	Ka përfunduar	Viti 2012

9	Paisja me teknologji informative për sallën e Kuvendit	K.K. Hani i Elezit	9.541.00€		Ka përfunduar	Viti 2012
10	Shenjzimi i kufirit Kadastral dhe mbrojtja e Pyjeve	UNDP Komuna Hani i Elezit	20,300.00 €	Geodata Kaçanik	Ka përfunduar	Viti 2012

III Kërkesat e qytetarëve– Personave fizik dhe juridik

Në fillim të gjashtë mujor të parë të vitit 2012 kemi shqyrtuar dy nga 4 kërkesa të mbetura të vitit 2011, nga të cilat dy janë ende në shqyrtim. Gjatë këtij gjashtë mujori të vitit 2012 Drejtorisë – Sektorit të Urbanizmit, i janë bërë 28 kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me Leje Ndërtimi, Leje Urbanistike, Pëlqime ndryshme, Leje pune etj.

Nga numri i lartpërmendur i kërkesave:

- 21 kërkesa janë miratuar
- 2 janë refuzuar si të pabaza
- 5 kërkesa janë në shqyrtim e sipër

Gjatë kësaj periudhe kemi lëshuar:


- 9 Leje Ndërtimi ,
- 10 Leje Urbanistike,
- 1 Leje Urbanistike për aneksin e shkollës fillore “Ilaz Thaçi - Faza II (për bashkëngjitje të aplikacionit për EURED),
- 2 Pëlqime.

IV Të Hyrat për vitin 2012 në sektorin e Urbanizmit

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 Sektori i Urbanizmit ka realizuar të hyra në shumë prej: **5,326.60 €**, që do të thotë 38% më shumë se gjashtëmujori i parë i vitit 2011.

#	Të Hyrat për tërë vitin 2012	
1	Nga dhënia e pëlqimeve të ndryshme.	20.00 €
2	Nga Lejet Urbanistike	100.00 €
3	Nga aplikacionet për leje ndërtimi	55.00 €
4	Nga taksat për leje ndërtimi	5,151.60 €
~	Gjithsej:	5,326.60 €

Tab.1. Paraqitja grafike e të hyrave.



V INSPEKTORI I NDËRTIMTARIS

Gjatë kësaj periode gjashtëmuajore si inspektor i ndërtimit përveç punëve dhe detyrave tjera ka bërë edhe:

Nga marsi 2010 ka filluar projekti ndërtimi i rrugaës Hani i Elezit Gorancë Rezhancë- Hunel. Punimet e mbetura të vitit të kaluar kanë vazhduar në dalje të lagjës së Re e deri te ura e Seçishtës ku një pjesë e rrugës është asfaltuar edhe pse kemi patur shumë probleme me banorët e lagjës së Re, për zgjerimin e rrugës me pronat private derisa është bërë shpronësimi i tyre.

Ka filluar rregullimi i trotuarit në fshatin Paldenicë nga Lagjja e Krasniqve e deri te shkolla fillore Kështjella e Diturisë punimet janë duke u kryer sipas projektit nga punëkryersi **Zuka Comerc** nga Gjilani.

Vizita ju kemi bërë edhe dy punishteve te shkolla fillore Ilaz Thaqi ku është duke u ndërtuar salla sportive edhe pse ka patur vërejtje gojore gjatë punimeve.

Gjat kryerjes së punimeve në teren si inspektor i ndërtimit kam bërë:

6 Procesverbale

6 Urdhëresa për leje rrënimi

1 Vërejtje me shkrim për ndërhyrje në infrastruktur në lagje të Re.

65 Inspektime të punimeve në teren.

VI -SEKTORI I KADASTRIT

Në sektorin e Kadstrit janë kryer këto punë dhe detyra: Identifikimi i pronës ,ndarja fizike te parcelave dhe rivendosja e parcelave në teren,regjistrimi i parcelave në librat kadastrale, lëshimi i Aktvendimeve kadastrale ,dhënia e certifikatës te pronës , kopje te planit, pikave të parcelave regjistrimi i hipotekave si dhe regjistrimi RDPP.

Në sektorin e Kadastrit në gjashtmuajorin e par të këtij viti janë kryer gjithësej **1474** lëndë nga të cilat janë vjel **7942.00€**

Vlen te ceket se zyra kadastrit në Hanit te Elezit ka fituar projektin e GIZ-it “2011-2013 ndihmë Kadastrit të Kosovës “, me të cilin kemi zhvilluar shumë takime dhe punëtori në kuadër të këtij projekti të dhe ka përfunduar me nënshkrimin e Memorandumit të mirëkuptimit ne mes te Komunës se Hanit të Elezit dhe GIZ-it.Në kuadër të këtij projekti zyra e kadastrit është furnizua me dy tavolina pune ,dy ormanë për dokumentacion te zyrës ,një GPS-dore dhe 8 karrige për zyre, një skaner A3 gjithashtu në këtë zyrë ndihmë profesionale po japin dy eksperte te gjeodezisë që nga data 13.04.2011.Është bërë adaptimi i zyrës së kadastrit .

Këto eksperte kanë përshkruar dhe skanuar tërë ecurinë – zhvillimin e kadastrit prej vitit 1955 e deri tani (kuptohet duke marre nga një shembull si për aparatit e vjetër – përshkruet kadastral ashtu edhe për atë te tanishmin), kanë bërë identifikimin e gabimeve kadastrale ku pjesa tekstuale nuk përputhet me pjesën grafike në Zonat Kadastrale Hani i Elezit , Seçishtë,Paldenicë,gjithashtu është në studim e sipër një pjesë e z. Kadastrale Seqishtë dhe pas përfundimit do të kërkohet nga AKK që të lejohet rikonstruimi i kësaj pjese të x. Kadastrale këto eksperte punën e kanë përshkruar në raportet e punës të cilët i posedon kjo drejtori.

VII MBROJTJA E MJEDISIT

Gjatë kësaj periudhe ka qenë e angazhuar si koordinator e komunës në hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis mbështetur nga Qendra Rajonale Mjedisore REC, financuar nga SIDA.

Përveç obligimit ligjor siç është Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 2009 (neni 24), që e obligojnë komunën e Hanit të Elezit si edhe çdo komunë tjetër, që të hartojë një plan të tillë, këtë të domosdoshëm edhe gjendja ekzistuese mjedisore që është tipike për një qytet me industri prodhuese të zhvilluar dhe me një qarkullim të madh të automjeteve nëpër rrugën magjistrale që lidhë Kosovën me Maqedoninë.

PLVM ofron mundësinë për një menaxhim efektiv të çështjeve mjedisore, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse dhe duke marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme edhe opinionin e publikut.

Ky dokument do të ofrojë mundësinë që komuna të kërkojë mbështetje financiare nga donatorët për të financuar projektet nga fusha e mbrojtjes së mjedisit.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti kemi pasur 9 takime me grupin punues dhe dy talime me grupin koordinues, kemi pregaditur ftesat dhe agjendën e të gjitha takimeve në bashkëpunim me koord. e REC-ut ku për çdo takim punues grupi ka qenë i njoftuar me kohë.

Kemi organizuar dy dëgjime publike.

Në kuadër të këtij projekti kemi pasur dy udhëtime zyrtare në Durrës në njërin udhëtim kanë marrë pjesë antarët e grupit punues kurse në udhëtimin e dytë kam marr pjesë un si koordinator e projektit ku kam prezantuar draft PLVM dhe është vlersuar shumë nga ekspertët.

Kemi mbajtur takime të rregullta pune me menaxherin e projektit të REC-ut dhe koordinatorit dhe përfaqësuesin a SIDA-s. .

Është bërë pregaditja e draftit për komitet dhe kuvend ku është miratuar nga antarët e kuvendit. Puna ka vazhduar me angazhimin e ekspertëve nga REC për PLVM ku i kemi ofruar të gjitha shënimet e kërkuara. Ky plan është miratuar nga Kuvendi Komunal me 30.05.2012.

- Me komisionin për vlersimin e kushteve për eksploatimin e minierave dhe dëmeve të shkaktuara me rastin e eksploatimit të pasurive minerale në tokën bujqësore-pyjore si dhe ndrrim destinimi kemi pasur **6 kërkesa** ku kemi dalur në vendin e ngjarjes dhe kemi perpiluar raportin dhe kemi përcjell për kuvend.
- Më 24 Maj kemi marrë pjesë në aksionin” **Ta pastrojmë Kosovën**” ku kanë qenë të angazhuar të gjitha institucionet dhe qytetar te komunës të cilët kanë marrë pjesë masovikisht në aksion,ne kemi percjellur aksionin në qytet dhe në të gjitha fshatrat.

- Është pregaditur urdhëresa për moshedhjen e mbeturinave në vende publike dhe janë shpërndar tek banorët e ndërtesës ne rrugën ka tregu i gjobër.
- Vërejtje për moshedhjen e mbeturinave i kemi bërë edhe subjekteve afariste ka kufiri.
- Kemi bashkëpunuar me MMPH për ndotjen e ajrit,ujrat e zeza,mbetjet e azbestit,me ISHP dhe IKSHPK për ujin,me AUV-akion për marrjen e strishove,inspektime për ushqimin etj.

Të hyrat e përgjithshme në DUKMM për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 është 13.268.60€

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtoria e SHMS-së në këtë gjashtëmujor ka realizuar planin e planifikuar për këtë periudhë te ketij vitit kalendarik 2012.

DSHMS-ja perveq kujdesit parësor shëndetësor në vete ka përfshirë edhe shërbimin social dhe atë sanitar.

Obligimet dhe detyrimet janë realizuar ne mbeshtetje të ligjit të shëndetësisë, ligjit të vetëqeverisjes lokale, ligjit për financa si dhe U.A dhe statutit të QKMF-së.

Gjatë kësaj periudhe kemi patur edhe zëvendësime të stafit punuës me punëtor të rinjë, ku këtë vit është pranuar për herë të parë edhe punëtorja me fakultet të infermierisë si gjeneratë e parë e këtij profili, që është një ndihmesë për stafin punues. Janë bërë me kohë edhe zëvendësimet e pushimit të lehonisë me punëtorë të rinjë duke rrespektuar ligjet mbi procedurat e konkursit. Punëtorët kanë shfrytëzuar pushimet vjetore sipas rregullave kështu që deri ne fund të këtij raporti të gjithë punëtorët kanë shfrytëzuar pushimet vjetore te vitit 2011.

Nga stafi punues kemi patur edhe masa disiplinore dhe masa tjera ne pagë për shkelje të detyrave të punës.

Gjate stines se dimrit është formuar ekipi emergjenti shëndetësisë i cili ka kryer shërbime shendetësore nëpër shtëpi. Këtij aksioni ju ka bashkangjitur edhe komuna me automjetet e veta, pasi që autoambulancat nuk ishin në gjendje që të qarkullojnë për shkak të borës në fshatra.

Objekti i QKMF-së edhe AF-së nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga viti i kalar. Edhe pse gjithnje ka përpjekje që të bëhet një zgjidhje për zgjerimin e hapsirës deri më tani nuk kemi arrit. Ka qenë një bashkëpunim mes „SHARRCEMIT dhe DSHMS-së që të realizohet projekti i aneksit për zgjerim, por nuk është arrit të filloj puna deri në këtë raport. Është bërë lyerja e një dhomë të mjekut që mbetet në të ardhmen që të bëhet edhe lyerja e dhomave tjera pasi që është nevojë.

DSHMS-ja ka realizuar planifikimet për periudhën janar – qershor 2012 dhe atë

- Ofrimi i kujdesit parësor shëndetësor brenda 24h.
- Sigurimi me kohë i barnave nga lista esenciale që furnizohemi nga MSH –ja.
- Sigurimi i reagensave nga buxheti komunal për analizat e gjakut – laborator, dhe sigurimi i medikamenteve dhe nevojave tjera për shërbimet stomatologjike .
- Furnizimi i rregullt me insulinë.
- Furnizimi i rregullt i vaksinave për vaksinimin e qytetarëve për moshë të ndryshme.
- Sigurimi i transportit për raste emergjente të referuara për qendrat spitalore si dhe sigurimi i transportit për pacientët në hemodializë.
- Vizitat e vazhdueshme QKMF-së dhe AF-së në Gorancë.
- Auditimi i brendshëm i QKMF-së nga komisioni komunal i Hanit të Elezit.
- Furnizime me dokumentacione mjeksore ne vlere prej 3,234.00 euro
- Takime të rregullta me kryetarin dhe drejtorët e drejtorateve.
- Kontrollimi i vazhdueshëm i inspektores sanitare në lokalet afariste dhe të tjera ne mbrojtje të shëndetit të qytetarëve.
- Raportimi i rregullt i të dhënave të SNS-së në DMS në Prishtinë .
- Raportimi i analizave të ujit të Gllloboqicës dhe ujit të Dimcës nga IKSH-ja
- Angazhimi për javën kulturore të muajit qershor.
- Menaxhimi i mjeteve financiare në kategoritë paga dhe mëditje, mallra e shërbime si dhe shpenzimet komunale.

DSHMS-ja gjatë kësaj periudhe ka patur bashkëpunim me MSH-në, MPMS-në, PK-në, DSHMS-në të Kaqanikut, spitalin rajonal të Ferizajit, Transfuzionin e gjakut, ‘‘CARITAS’’-in e Luksemburgut, ‘‘Sharr Cem’’ ,REC, IKSHP. I gjithë ky bashkëpunim ka qenë në interes të DSHMS-së ku nga CARITAS-i i Luksemburgut kemi përfituar në emër të komunitetit të fshatit Seqishtë mjete dhe aparaturë për QKMF-në në Han të Elezit, si dhe një gjenerator në vlerë rreth 10.000 euro.

Drejtoria e DSHMS-së ka mbajtur takim me IKSHP për ujin e pijshëm ku si propozim IKSHP jep, që uji i burimit të Gllloboqicës të klorifikohet dhe mund të bëhet i pijshëm. Si dhe propozoi për ujin e dimcës që të rregullohen disa kaptazhe për fundrrimin e ujit që t’i mundesohet aparatit të ujit për një filtrim më të lehtë, pasi që uji ndotet me të madhe kur ka të reshura atmosferike. Klorifikimi i ujit ka filluar të bëhet dhe tani lagjja e Re ka ujë të pijshëm.

QKMF-ja Janar- Qershor 2012

Tabellar mbi punën e QKMF-sw

MUAJI	Kartoteka	Intervenimet	Stomatologjia	Laboratori	Vaksinimi
Janar	2296	1516	138	75	71
Shkurt	1678	1110	140	119	209

Mars	2445	1740	162	212	136
Prill	2081	1410	165	169	146
Maj	1938	1612	171	173	218
Qershor	2012	1207	73	175	78
GJITHËSEJTË	12450	8595	849	923	858

INSPEKTORJA SANITARE

Punët e kryera i kemi paraqitur në formë tabelare:

Pranime sanitare –teknike mbi plotësimin e kushteve higjeno-sanitare	6	Subjekte afariste
Marrja e mostrave të ushqimit	20	+ AUV
Marrja e mostrave të ujit për analizë	32	12- kimike 22- bakterore
Inspektimi i ujërave të zeza	5	

Procesverbale të lëshuara gjatë inspektimit	23	
Aktvendime	15	Për gjobë mandatore
Urdhëresa	4	3-Për DDD
Kërkesa te ndryshme	6	
Libreza sanitare - punëtorët që merren me shitjen dhe prodhimin e artikujve ushqimor që kanë të kryer kontrollin shëndetësor	90 %	Vërejtje për vazhdim të librezave sanitare
Inspektime të tregut	22	Tregu i gjelbër
Inspektim i furrave të bukës	5	Vërejtje
Marrja e strishove nga mjetet e punës, uniformat e punës etj.	20	Në bashkëpunim me AUV dhe ISHP-Ferizaj
Inspektime të objekteve të prodhimeve të mishit	3	Në bashkëpunim me AUV.
Inspektime të barnatoreve farmaceutike -	2	
Inspektimi i Salloneve të ondulomit (frizere)	6	
Vërejtje për klorizimin e ujit të pijes, për	1	Uka Saraj

vendosjen e aparateve për klorizim të ujit , për eliminimin e të metave në puse		
Inspektime së bashku me Inspek. e tregut	32	Për pagesën e taksave komunale
Pjesmarrja nëpër trajnime	7	Lidhur me sanitari, ambient, etj.

Qendra Për Punë Social

Nr.	Sherbimi	Nr.i punëtorëve
1.	Sherbimet Sociale.	1.
2.	Sherbimi I SNS.	1.
GJ.	2.	2.

SHERBIMI SOCIAL RASTET E DHUNES

Me anë të kësaj shkrese ju paraqesim Raportin numeric të rasteve të dhunës për periudhën

(janar-Qershor 2012.)

<i>1.</i>	<i>Dhuna në familje</i>	<i>2</i>
<i>2.</i>	<i>Dhuna jasht familjes</i>	<i>0</i>
<i>Gjith</i>	<i>-</i>	<i>2</i>

Fëmijët dhe të miturit në strehim familjar

(Fëmijet jetim)

Gjatë periudhës gjashtmure 01.01.2012-30.06.2012. përveq rasteve të bartura nuk kemi

Raste të reja.

Fëmijët pa dy prindër

Në Qendrën Për Punë Sociale Hani I Elezit gjenden gjithsej shtatë (7) fëmijë të bartur nga periudha e mëparshme, ndërsa raste të reja gjatë periudhës gjashtmujore 2012 nuk ka. Ju bëjmë me dije se edhe për vitin kalendarik 2012 nga DSHS- Prishtinë Qendra Për Punë Sociale Hani I Elezit ka lëshuar Vendimet dhe Kontratat për Kujdestarët Ligjor të fëmijëve. Në tabelarët e më poshtëm po japim detallet më hollësisht.

Fëmijët në strehim familjar pa pagesë nga DSHS të MPMS

Fëmijë në strehim familjarë pa pagesë kemi dy raste

Fëmijët dhe të miturit nëkonflikt me ligjin
(Delikuentët)

Gjatë periudhës gjashtëmuajore pranë Qendrës për Punë Sociale Hani i Elezit kemi një (1) rast të sjelljes devijante të të miturve. Ky rast egziston edhe sot e kësaj dite i pa riparuar përshkak të raporteve dhe marrdhënjeve të qrrregulluara familjare.

Fëmijët dhe të miturit me aftësi të kufizuara
(Fëmijët me retardime të rënda fizike dhe mentale)

Në bazë të Udhëzimit administrative nr.03-2009. Për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për rrealizimin e të drejtës në ndihmën material kemi tetë (8) dhe atë të bartur nga periudha e kaluar. Gjatë kësaj periudhe Komisionit mjeksor I janë nështruar edhe 4. Raste të reja nga të cilët 3. Janë refuzuar ndërsa 1 gjendet në plotësim të dokumentacionit.

R A P O R T

(Mbi adoptimin e fëmijëve)

* Gjatë periudhës Janar-Qershor 2012. Pranë Qendrës Për Punë Sociale Hani i Elezit kemi një (1) familje adoptuese e bartur. Kjo familje vitin e kaluar ka adoptuar fëmijë të gjinisë femrore tani është në pritje për adoptim të fëmijut të gjinisë mashkullore.

Gjatë kësaj periudhe pranë kësaj Qendre nuk kemi pasur fëmijë të braktisur

Punët dhe detyrat tjera të kryera nga fushveprimtarija e Sherbimit social.

Nr.	Rastet	Nr.
1	Trafikimi I qenjeve njerëzore.	0.
2	Përdorimi I substancave toksikomanike	0.
3	Vertetime të ndryshme	22
4.	Bashkpinim me SHPK	3
5.	Bashkpunim me Gjykatë	4.
6.	Seminar, trajnime.etj	4.
7.	Bashkpunim me Qendra simotra.	po.
8.	Bashkpunim me shkolla	po.

Raporti gjashtëmuajor I Asistencës Sociale Janar-Qershor 2012
Raporti I Shpërndarjes së ndihmave
Sociale-Janar-Qershor 2012

Muaj	Numri i familjeve	Shuma në para	Numri I anëtarëve të familjes
Janar	221	13260	995
Shkurt	234	14040	1053

Mars	196	11760	882
Prill	239	14340	1075
Maj	248	14880	1116
Qershor	254	15240	1144
Gjithsejt	1392	83520	6265

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË RINI DHE SPORT

DKA-ja gjatë periudhës gjashtë mujore ka kryer punët dhe detyrat të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe ngritjen e cilësisë në mësim përmes pajisjes së shkollave me material të nevojshëm si dhe organizimin e trajnimeve për mësimdhënës.

Janë mbajtur takimet e rregullta në MASHT, në bordin e drejtorëve me kryetarin dhe me drejtorët e shkollave.

Gjatë kësaj periudhe të gjitha shkollat e komunes sonë janë përballur me të ftohtin që përfshiu edhe territorin e Republikës së Kosovës , ku nga Ministria e Arsimit të Kosovës është marrë vendimi përshtyerjen e procesit edukativo-arsimor nga data 06.02.2012 deri me 13.02.2012. Gjatë kësaj kohe drejtori i DKA-së , zyrtari për arsim, si dhe pedagogu i shkollës kanë bërë vizita nëpër shkollat e komunës sonë për të parë gjendjen për së afërmi dhe për të marrë masa për evitimin e defekteve të shkaktuara nga acari. Gjatë kësaj kohe ka pasur vetëm në shkollën e mesme „Dardania“ defekte në nxemjen qëndrore ,ne gypat e ujesjellësit dhe tualete.

Me punën dhe angazhimin e drejtorit të shkollës dhe stafit të saj janë arritur të evitohen të gjitha dëmet ku DKA-ja i ka siguruar materialin e nevojshëm për dëmin që ju ka bërë.

Gjatë muajit shkurt është bërë furnizimi me lënd djegëse (naftë), në shkollën fillore të mesme të ultë „Ilaz Thaçi“ dhe në shkollën e mesme të lartë „Dardania“.

Vizitat e realizuara nëpër shkolla; Prej dt.01.02.2012 deri më dt 30.06.2012 kemi realizuar 10 vizita nëpër shkollat fillore , të mesme të ulët dhe të mesme të lartë,ku kryesisht është inspektuar, mbarvajtja e procesit mësimor, realizimi i orëve mësimore, përgatitjet e orëve mësimore dhe higjiena nëpër objektet shkollore. Gjat vizitave kemi konstatuar se në aspektin infrastrukturor gjendja është e mirë, mësimdhënësit kanë qenë të përgatitur me plane vjetore, mujore dhe ditore në përjashtim të rasteve të rralla ku ndonjë mësimdhënës nuk ka pas përgatitjet ditore, për arsye të ndryshme.

Në aspektin higjienik konstatojmë se gjendja ka qenë e mirë në të gjitha shkollat. Materiali pedagogjik nëpër shkolla plotësohet me përpikëshmëri .

Investimet dhe donacionet nëpër shkolla

-Vendosja e kamerave për monitorim në 4 shkolla dhe ate : SHFMU – shkolla amë „Ilaz Thaçi“ SHFMU- Kështjerlla e Dituris“ Paldenicë, SHFMU „Veli Ballazhi“ në Gorancë dhe SHML „Dardania „ Hani i Elezit,

-Paisja e SHFMU „ Kështjella e Dituris „ Paldenicë me Tabela të ekspozitave me paisje sportive dhe tabela të pinkponit ,donaciaon nga Llogosi në vlerë prej 2,000.00 euro.

- QPE-a në participim me Komunën e Hanit të Elezit është në realizim të projekteve të parqeve të shkollave në vlerë prej 2,475.00 euro

-Karitasi i Liksemburgut ka pais shkollat me vegla pune për punëtorët higjenik të gjitha shkollat e Komunës së Hanit të Elezit me vlerë prej 2,400.00 euro.

USAID-di ka hap qendrën për trajnimin e mësimdhënësve „Klasa e shekullit 21“ në SHFMU“Kështjella e Dituris“ në Paldenicë.

Donacioni nga Komisioni European i cili ka furnizuar bibliotekën komunale me 436 libra dhe 223 tituj me vlerë 3000 €.

Gjatë periudhës gjashtë mujore kemi pasur 82 kërkesa prej palve të ndyshme dhe të gjitha janë të miratuara.

KULTURA

Me datën 17.02.2012 është organizuar një program kulturo-artistik për Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë muajit maj është riaktivizuar shoqëria kulturo-artistike Sharri nga Hani Elezi, si dhe është hap Bibloteka komunale në shtëpin e kulturës „ Imri Curri“ në Hani të Elezit.

Gjatë muajit Qershor Drejtoria për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport ka udhëhequr me sukses aktivitetin që janë mbajtur për nder të Ditës së Çlirimit – 11 Qershori duke u nisur nga data 01.06.2012 deri me datën 11.06.2012, ketu janë mbajtur gara në futboll të vogël , në volejball, krosi i qytetit dhe është mbajtur ekspozita nga nxënësja e klasës IX Arbonita Bushi në shtëpin e kulturës , në fund në përmbyllje javës kulturore është shfaqur një program festiv me shoqërinë kulturo-artistike Sharri.

Më poshtë po paraqesi në formë tabelare : Aktivitetet sportive, shpërblimet, shpenzimet, sasia, çmimi, shuma dhe donatorët që na kanë ndihmuar.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR "JAVËN KULTURORE 2012" 11 QERSHORI HANI I ELEZIT		
SHPENZIMET TOTALE PËR TË GJITHA AKTIVITETET	TË PLANIFIKUARA	TË REALIZUARA
Gjithsej shpenzime në pingpong.	220.00	66.00

Gjithsej shpenzime në volejboll.	255.00	187.00
Gjithsej shpenzime në ekspozitë.	119.00	209.01
Gjithsej shpenzime në futboll.	430.00	335.99
Gjithsej shpërblime kupa dhe medaljone në vrapim (kros).	282.00	/
Gjithsej shpenzime në vrapim (kros)	575.00	620.00
Gjithsej shpenzime për musafir.darka te Alba Oil	1,800.00	3,045.00
TOTALI	3,681.00	4,463.00
Donacioni nga OJQ"SPEKTRI" Donacion nga PRO CREDIT BANK 100 maica Donacion nga NLB BANK.100 maica Këngëtarja Lori donacion nga NTP "LURI"		1,082.00
Shpenzime Komunale		3,381.00

17 EKIPE TË PARAQITURA NË FUTBOLLIT MË DATË 26 MAJ 2012 .

Emërtimi	TË PLANIFIKUARA			TË REALIZUARA		
	Sasia	Çmimi	Shuma	Sasia	Çmimi	Shuma
PARTICIPIMI I EKIPIT	17	10	170.00	17	10.00	170.00
SHPENZIMET	Sasia	Çmimi	Shuma	Sasia	Çmimi	Shuma
Referimi i lojëve nga data 01,10.06.2012.	3	50.00	150.00	3	33.33	99.99
Mbushje telefoni për referët 01,10.06.2012.	0	0	0	3	5.00	15.00
Ushqim referët nga data 01,10.06.2012.	0	0	0	3	11.66	34.98
Mbushje telefoni për komisionin organizativ.	4	5.00	20.00	4	5.00	20.00
Gjithsej shpenzime e 17 ekipeve që kanë participuar			170.00	Gjithsej shpenzime		169.97

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.